



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 677 Akti

Nr. 731 Vendimi
Tiranë, më 12.1.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja Kryesuese
Brunilda Bektashi Relatore
Lulzim Hamitaj Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 10.1.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arbër Berexha**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit e Përgjithshëm Elbasan.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Brunilda Bektashi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Arbër Berexha, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit e Përgjithshëm Elbasan, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK; Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Arbër Berexha, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bektoshi dhe Etleda Çiftja. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bektoshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Arbër Berexha, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisioneren Etleda Çiftja. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, në datën 29.1.2021¹ dhe datë 16.10.2023, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
6. Në datën 18.12.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Arbër Berexha, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 4.1.2024 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 18.12.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën. Në datën 21.12.2023, subjekti u njoh dhe u pajis me kopje të dokumentacionit të dosjes. Në datat 4.1.2024 dhe 6.1.2024, subjekti dërgoi në rrugë elektronike dhe zyrtare shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.
8. Trupi gjykues, në datën 5.1.2024, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Arbër Berexha në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 5.1.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 10.1.2024, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

¹ Në përmbajtje të përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, administruar në dosjen e Komisionit.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Arbër Berexha u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arbër Berexha. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 10.1.2024, për të rifilluar më 12.1.2024 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Arbër Berexha ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kërkesave IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar nr. *** prot., datë 28.2.2018, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arbër Berexha, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ku më parë subjekti, në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ; (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 26.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Automjet tip “Mercedes-Benz” Class C, vit prodhimi 2001, me targë ***, blerë në vitin 2015, me vlerë 1.400 euro + 20 euro pagesë komision banke. Pagesë për doganën 54.400 lekë dhe pagesë për regjistrim mjeti 15.555 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga e vitit 2015. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.

17.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i Komisionit

17.2 Nga verifikimi i deklaratave të plotësuara nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se ai e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, me përshkrimin

³ Faturë shitjeje mjeti tip “Mercedes-Benz CDI 200”, viti prodhimi 2001, blerë në Itali në mars të vitit 2015, dokument i përkthyer në shqip sipas vërtetimit nr. ***, datë 30.03.2015; faturë doganore; urdhër xhirimi; mandat arkëtimi datë 26.3.2015; veprim në llogari derdhje *cash*, datë 20.3.2015, Credins Bank; faturë tatimore nr. ***, datë 8.4.2015, nr. ***, datë 8.4.2015 dhe nr. ***, datë 8.4.2015; certifikatë pronësie e mjetit me targë ***, datë 8.4.2015, në emër të z. Arbër Berexha (aneks nr. 4/2, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

“Autoveturë tip Mercedes, Class C, vit prodhimi 2001, me targë ***, blerë në vitin 2015. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga e vitit 2015”.

17.3 DPSHTRR-ja⁴ informoi se shtetasi Arbër Xh. Berexha aktualisht ka të regjistruar automjetin me targë ***. Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion dosjen e plotë, nga ku rezulton se automjeti është blerë nga shtetasi A.K në vlerën 1.400 euro. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se mjete është zhdoganuar në datën 26.3.2015, sipas deklaratës doganore nr. *** për vlerë mjete 1.400 euro dhe është paguar TVSH në shumën 54.345 lekë.

17.4 Nga analizimi i *statement*-it rezulton se subjekti i rivlerësimit ka transferuar nga llogaria e tij bankare në Credins Bank shumën 1.400 euro, në datën 20.3.2015, për shtetasin A.K, me përshkrimin “Për blerje mjete”.

Lidhur me burimin e krijimit

17.5 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat nga paga e vitit 2015. Komisioni kreu analizën financiare në datën 20.3.2015 kur është kryer likuidimi i çmimit të mjetit, duke marrë në konsideratë vetëm pagat e përfituara gjatë vitit 2015 dhe jo pakësimin e kursimeve të akumuluar.

17.6 Nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 32.397 lekë për të investuar në blerjen e automjetit, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës⁵ për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

17.7 Në qëndrimin e tij subjekti ka parashtruar se ai, si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në DPV- në e vitit 2015, i është referuar të ardhurave nga paga si burim krijimi për blerjen e automjetit. Në këtë periudhë ai ka kursyer të ardhurat nga paga dhe për jetesë ka shpenzuar nga kursimet e tij, gjendje *cash* në banesë.

17.8 Subjekti ka parashtruar se të ardhurat nga paga në shumën 250.984 lekë për këtë periudhë kanë mbuluar vlerën e blerjes së automjetit në shumën 196.700 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës janë përballuar nga kursimet *cash*. Për këtë arsye, sipas subjektit, për sa kohë rezulton që në fund të vitit 2014 ai ka pasur kursime *cash* në shumën 900.000 lekë, do të thotë që në momentin e blerjes së automjetit nuk mund të rezultonte me pamundësi financiare në shumën -32.397 lekë.

17.9 Subjekti ka kërkuar konsiderimin e këtyre burimeve si të përdorura për financimin e kësaj pasurie, vlerësim ky që sipas tij duhet bërë në harmoni me deklaratimet e tij në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe me logjikën e përdorur po prej tij. Subjekti ka nënvizuar qëndrimin e konsoliduar tashmë të Kolegjit, duke cituar edhe disa prej vendimeve të këtij institucioni⁶, ku thuhet se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Mbi argumentet e pretenduara më sipër, subjekti ka deklaruar se në momentin e blerjes së automjetit, në datën 20.3.2015 ai ka pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të blejë këtë pasuri në vlerën 196.700 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2021.

⁵ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁶ Vendimi nr. *** dhe vendimi nr. ***, datë 16.2.2023.

17.10 Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe shpjegimeve të subjektit, vlerëson të marrë në konsideratë argumentet e prezantuara prej tij, duke i çmuar ato bindëse.

17.11 Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion duke vlerësuar deklaratat e subjektit në deklaratat përkatëse, ku në mënyrë konsistente ai ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri të ardhurat nga pagat, të cilat si burim i ligjshëm rezultojnë të mjaftueshme për krijimin e pasurisë automjet, në shumën 196.700 lekë.

17.12 Lidhur me pretendimin e tij se për shpenzimet jetike ai ka përdorur kursimet e tij në vitin paraardhës, trupi gjykues i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit, duke çmuar faktet konstatuese, ku: (i) rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vitin pararendës dhe aktual kur është kryer investimi dhe nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti kishte pasur mundësi të krijonte gjendjen në shumën 900.000 lekë; (ii) balanca negative për 3 muajt e parë të vitit rezultoi në një vlerë relativisht të ulët, çka lejon mundësinë që për shpenzimet e jetesës të jetë përdorur gjendja *cash* e mbartur; (iii) lidhur me kursimet *cash* për vitin 2015, për të cilin subjekti ka deklaruar se ka kursyer 400.000 lekë me burim pagat e vitit 2015, rezultoi se subjekti kishte mundësi t'i krijonte ato, çka nënkupton se pas diferencës mes të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit, kjo shumë ka qenë mundësia e tij për kursim.

17.13 Në përfundim për këtë çështje, trupi gjykues vlerëson se edhe në çmuarjen e një pasaktësie në deklaratim kjo e fundit mbetet e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe, si e tillë, nuk mund të konsiderohet si shkak që mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

18. Depozitë në BKT, krijuar në datën 2.12.2016. Vlera: 1.400.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat e pagës. Dokumentacion ligjor⁷: (a) kontratë depozite me nr. reference ***, datë 2.12.2016; (b) veprim në llogari derdhje *cash*, datë 2.12.2016.

18.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja dhe DPPPP-ja.*

18.2 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021, informon se z. Arbër Berexha ka produktin depozitë pranë kësaj banke.

18.2.i Nga verifikimi i llogarisë bankare në BKT rezulton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën 1.400.000 lekë në datën 2.12.2016. Kjo shumë është investuar në depozitë në datën 5.12.2016.

18.2.ii Gjendja e llogarisë në datën 26.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, rezulton në vlerën 1.400.000 lekë.

18.2.iii Në analizë, për sa u konstatua më sipër, trupi gjykues vëren se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

18.3 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite, rezulton se në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në banesë nga kursimet nga pagat në vite.

18.4 Komisioni analizoi kursimet e subjektit, ku referuar deklaratimeve periodike rezultoi se subjekti ka deklaruar:

- Në vitin 2013: *“Gjendje në cash, kursime nga paga, në shumën 300.000 lekë”*.

- Në vitin 2014: *“Kursim për vitin 2014 nga paga si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në shumën 600.000 lekë”*.

⁷ Administruar në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi nr. 4/3.

- Në vitin 2015: “Gjendje cash në banesë, 400.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga e vitit 2015, në shumën 400.000 lekë”.

- Në vitin 2016: “Pakësim i gjendjes cash në banesë nga kursimet nga pagat në vite”, në shumën 1.400.000 lekë”.

18.5 Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2013 – 2016, periudhë në të cilën datojnë kursimet e subjektit, duke përfshirë gjithashtu edhe të ardhurat dhe shpenzimet familjare të identifikuara.

18.6 Nga analiza financiare, Komisionit i rezultoi se dukej se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin pasur mundësi financiare në shumën 951.861 lekë në vitin 2013, të përballonin investimet, shpenzimet, si dhe të shtonin kursimet e tyre dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës⁸ për të provuar të kundërtën e konstatimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.7 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera në qëndrimin e tij, ka shpjeguar se në vitin 2013 ka deklaruar për herë të parë “Shtesë të kursimeve cash” në shumën 300.000 lekë nga kursimet nga paga. Subjekti ka konfirmuar se prindërit e tij në këtë periudhë kanë pasur një depozitë bankare pranë Credins Bank në shumën 945.261 lekë, që kishte si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kavajë dhe interesat e përfituara nga kjo depozitë, e cila do të përdorej për pagimin e këstit të fundit prej 3.871 euro për blerjen e apartamentit.

18.8 Subjekti ka evidentuar veprimet bankare të kryera nga prindërit, dhe më konkretisht ka specifikuar se në datën 28.8.2013 babai i tij ka depozituar në Raiffeisen Bank shumën 800.000 lekë, ka tërhequr 100.000 lekë në datën 23.12.2013 dhe gjendja në fund të vitit 2013 ka qenë në shumën 700.000 lekë. Në datën 17.8.2013 është nënshkruar kontrata e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt “Dhurimi i një prone pasuri e paluajtshme tokë arë me sipërfaqe 2.925 m², me vendndodhje në fshatin B, Komuna L.V, Kavajë”. Subjekti ka konfirmuar se një prej dhuruesve ka qenë nëna e tij M.B dhe se pranues të dhurimit kanë qenë shtetasit I, N dhe R.L. Subjekti ka saktësuar se nëna e tij ka përfituar nga nipërit e saj I. dhe R.L, shumën 800.000 lekë në shenjë mirënjohjeje për dhurimin e pjesës takuese të pasurisë tokë arë. Ai ka deklaruar se kontrata e dhurimit është një akt ligjor i bërë sipas kërkesës së shtetasve I. dhe R.L kundrejt një shpërblimi, duke qenë një marrëdhënie e posaçme e ngushtë familjare e nënës së tij me nipërit e saj. Subjekti ka shpjeguar se ai nuk ka pasur dijeni në lidhje me veprimet juridike të nënës së tij në atë kohë dhe se arsyeja që kalimi i pronësisë është bërë me dhurim dhe jo me akt shitblerjeje është si pasojë se kalimi i pronësisë po bëhej brenda bashkëpronarëve të pasurisë, të cilët kanë lidhje familjare të posaçme, dhe jo palëve të treta jashtë bashkëpronësisë.

18.9 Subjekti ka sqaruar se ai nuk ka pasur asnjë lidhje me llogarinë bankare të babait të tij, por në kuadër të procesit të *Vetting*-ut, kur ka marrë dijeni se nuk është paguar detyrimi tatimor për këtë të ardhur, ka vendosur të paguajë detyrimin tatimor në përputhje me nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe për këtë ka depozituar dokumentin urdhërpagesë 1800 “Tatimi mbi të ardhurat individuale” datë 4.1.2024 dhe mandatarkëtimin bankar, datë 4.1.2024; urdhërpagesë datë 5.1.2024 dhe mandatarkëtimin datë 5.1.2024 në Credins Bank, në emër të nënës së tij M.B.

18.10 Subjekti ka deklaruar se në fund të vitit 2013 nga shuma e dhuruar kishin mbetur gjendje në llogari 700.000 lekë dhe në vitin vijues ishte tërhequr e gjithë shuma.

⁸ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

18.11 Subjekti, duke referuar edhe dispozitën ligjore⁹, ka sqaruar se nëna e tij si përfituese e shumës së dhuruar nuk ka qenë subjekt deklarues në cilësinë e personit të lidhur në vitin 2013.

18.12 Subjekti ka deklaruar se duke qenë se shuma 800.000 lekë është përdorur për shpenzime mobilimi dhe shpenzime të tjera jetese dhe nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie të paluajtshme apo të luajtshme, ajo nuk është pasqyruar në deklaratën *Vetting* të prindërve të tij.

18.13 Subjekti ka parashtruar se për këtë çështje duhet të mbahet në konsideratë edhe koha e afërt të depozitimit të kësaj shume nga babai i tij në Raiffeisen Bank në datën 28.8.2013, me nënshkrimin e kontratës së dhurimit në datën 17.8.2013, duke theksuar në këtë mënyrë lidhjen kohore kronologjike ndërmjet shumës së përfitur nga dhurimi dhe depozitimit të saj në bankë, e cila, sipas tij, përbën një lidhje shkakësore, shkak - pasojë të veprimeve.

18.14 Subjekti ka depozituar edhe deklaratat noteriale¹⁰ të pranuesve të dhurimit, të cilët kanë i dhënë shumën 800.000 lekë nënës së tij në shenjë mirënjohjeje të dhurimit të bërë.

18.15 Subjekti, për të provuar mundësitë financiare të pranuesve të dhurimit, ka depozituar të ardhurat e realizuara të shtetasit R.L në shtetin italian në vitet 2011, 2012 e 2013, si dhe të shtetasit I.L, për vitet 2011 e 2012 (akte të përkthyer dhe të noterizuara).

18.16 Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që në analizën financiare të vitit 2013 të përfshihet shuma e dhuruar prej 800.000 lekësh, nga të cilat 700.000 lekë kanë qenë gjendje në fund të këtij viti.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti në prapësime lidhur me këtë çështje, arsyeton si vijon:

18.17 Sipas dokumentacionit të administruar, rezultoi e provuar marrëdhënia kontraktore e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.8.2013, midis nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. M.B, dhe familjarëve të afërt të saj (nipërve), kontratë gjithashtu e raportuar edhe nga noteri në RNSH pranë Ministrisë së Drejtësisë¹¹, por ky dhurim nuk është deklaruar nga nëna e subjektit në deklaratën *Vetting* dhe as gjatë hetimit administrativ, por është deklaruar vetëm në prapësime.

18.18 Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se kjo e ardhur nuk është deklaruar nga nëna e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, sikurse janë deklaruar të gjitha të ardhurat e tjera të përfituara, përfshirë edhe ato nga pensioni i pleqërisë, për më tepër që këto të ardhura pretendohen të përfituara në vitin 2013, kur subjekti ishte në detyrë dhe njëkohësisht subjekt deklarues.

18.19 Pavarësisht faktit se nga hetimi konstatohet se babai i subjektit ka depozituar shumën 800.000 lekë në datën 28.8.2013, në Raiffeisen Bank, pra pak kohë pas realizimit të kontratës së dhurimit, rezulton se kjo shumë është lëvruar në *cash* pa përshkrim për burimin e tyre që vijnë nga kjo kontratë dhurimi, çka pamundëson Komisionin që të krijojë bindjen mbi vërtetësinë e këtij deklarimi lidhur me faktin nëse shuma 800.000 lekë e depozituar në Raiffeisen Bank nga babai i subjektit është me burim krijimi kursime, shitje pasurie etj.

18.20 Trupi gjykues çmon gjithashtu se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kjo shumë nuk është deklaruar, pasi ajo është shpenzuar për arredim dhe shpenzime jetese dhe se nuk ka shërbyer si burim krijimi i ndonjë pasurie, për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar një burim të tillë kur është pyetur në lidhje me shpenzimet për arredim. Deklaratat noteriale të nipërve të nënës

⁹ Neni 3, pikat 11 dhe 19 të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Mbi deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”.

¹⁰ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.2023 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹ Referuar shkresës nr.*** prot., datë 12.03.2021, të këtij institucioni, administruar në dosjen e Komisionit.

së subjektit, të realizuara e depozituara vetëm në prapësime, për sa kohë nuk vijnë në harmoni me faktet e tjera të dala përgjatë hetimit, ku nuk rezultoi ndonjë provë e kohës për dhënien e kësaj shume, sikurse edhe për tjetërsimin e pasurive në emër të dhuruesve, çmohen nga trupi gjykues pa vlerë provuese në këtë çështje objekt vlerësimi, çka bën të panevojshme edhe analizimin/vlerësimin e mundësive financiare të tyre për t'i dhuruar nënës së subjektit shumë e pretenduar.

18.21 Në përfundim, trupi gjykues, nisur nga faktet dhe rrethanat më sipër të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe, për pasojë, konkludohet se kjo shumë nuk mund të llogaritet në të ardhurat e përfituara.

18.22 Në vijim, trupi gjykues për këtë çështje konstatoi se balanca negative për vitin 2013 afektohet si rezultat i vlerësimeve në çështjen e pasurisë apartament me sip. 92.7 m², për sa kohë kjo pasuri ka pasur si burime kursime të familjes, si më poshtë do të trajtohet/arsyetohet.

Deklarimi i pasurive të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit

19. Truall me sip. 383 m², nga ku ndërtesë 1 kat 110 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë lagjja “P.”, Elbasan. Burimi i krijimit të kësaj pasurie: trashëgimi nga babai, e cila është çelur me vendimin nr. ***, datë 22.9.2016¹², të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pjesa takuese: 1/3. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹³:

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarami i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i Komisionit

19.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike të pasurisë rezultoi se bashkëjetuesja e subjektit e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në deklaratën për vitin 2016, me përshkrimin “Truall me sip. 383 m²”, nga ku ndërtesë 1 kat 110 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë lagjja “P.”, Elbasan, me burim krijimi trashëgimi nga babai.

19.3 Nga dokumentacioni i administruar nga subjekti (i përcjellë dhe nga ASHK/Drejtoria Vendore Elbasan¹⁴, me dokumentacionin e konfirmimit të kësaj pasurie) konstatohet se me vendimin gjyqësor¹⁵ nr. ***, datë 22.9.1999, me objekt “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka çelur dëshminë e trashëgimisë ligjore për të ndjerin/trashëgimlënësin I.H. Sipas kësaj dëshmie, rezulton se trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit H. janë nëna e bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj. N.H, dhe dy vajzat, përkatësisht R.H dhe M.H, të cilat trashëgojnë në pjesë ta barabarta 1/3 çdo të drejtë e detyrim të trashëgimlënësit, ku përfshihet çdo pasuri e gjendur në emër të tij.

19.4 Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezultoi se Drejtoria Vendore e ASHK-së, dega Elbasan¹⁶, konfirmon bashkëpronësinë e znj. H. (bashkëjetuese e subjektit të rivlerësimit) së bashku me nënën e saj dhe motrën, në pasurinë nr. ***, të llojit truall, me sip. 383,6 m², me ndërtesë banimi 1 kat 110 m², ndodhur në lagjen “P.”, Elbasan, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 13.12.2013, vol. ***, f. **, me kufizimet përkatëse.

19.5 Sipas vërtetimit hipotekor, origjina e pasurisë daton më 4.2.1994. Kjo pasuri konfirmohet edhe me hartën treguese bashkëngjitur vërtetimit hipotekor.

¹² Duket se viti 2016 është lapsus në të shkruar, pasi nga aktet rezultojnë se dëshmia e trashëgimisë është e vitit 1999.

¹³ ZVRPP Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2016, konfirmon se shtetasja M.H ka të regjistruar në bashkëpronësi (1/3 pjesë) pasurinë nr. ***, z. k. ***, bashkëlidhur kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit truall me sip. 383 m² dhe ndërtesa me sip. 110 m² (aneksi nr. 4/5, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Aneksi nr. 27, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

19.6 Informacioni i përcjellë nga Drejtoria Vendore e ASHK-së, dega Elbasan, konfirmon gjithashtu se është bërë edhe rivlerësimi i kësaj pasurie në datën 19.10.2020, në shumën 15.000.840 lekë.

19.7 Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e depozituar, trupi gjykues vëren se përputhet deklarimi i bashkëjetueses së subjektit me dokumentacionin e administruar për këtë pasuri.

20. Ullishtë¹⁷ me sip. 5.311 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë lagjja “****”, Elbasan. Burimi i krijimit: trashëgimi nga babai. Pjesa takuese: 17/96. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹⁸.

20.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i Komisionit

20.2 Nga aktet e administruara rezulton se bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën për vitin 2016 në të njëjtën mënyrë sikurse ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

20.3 ASHK/Drejtoria Vendore Elbasan¹⁹ konfirmon se znj. H, nëna e saj N.H dhe motra R.H (si trashëgimtarë të të ndjerit I.H) figurojnë bashkëpronarë me të tjerë në pasurinë e llojit ullishtë, me nr. pasurie. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, me sip. 5.311 m², ndodhur në z. k. ***, Elbasan. Kjo drejtori ka bashkëngjitur edhe dokumentacionin mbështetës.

20.4 ZQRPP-ja²⁰, me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2017, 2.10.2017 dhe 12.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjet e ZVRPP-së Elbasan, me nr. *** prot., datë 23.8.2017, nr. *** prot., datë 22.9.2017 dhe nr. *** prot., datë 20.9.2017, të cilat konfirmojnë se shtetasja M.H ka të regjistruar në bashkëpronësi (me 10 shtetas të tjerë) pasurinë nr. ***, z. k. ***. Në seksionin e pronësisë në kartelën e pasurisë nr. ***, vol. ***, f.***, z. k. ***, e llojit ullishtë me sip. 5.311 m², sipas AMTP-së, janë të pasqyruara emrat e 11 bashkëpronarëve.

20.5 Gjithashtu, bashkëjetuesja e subjektit ka depozituar²¹ kartelën përkatëse të pasurisë, certifikatën e regjistrimit të saj, me datë regjistrimi 13.7.2016, si dhe vendimin nr. ***, datë 22.9.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë”.

20.6 Nga verifikimi i dokumentacionit, Komisionit i rezultoi se pasuria objekt hetimi është regjistruar në emër të disa bashkëpronarëve, ku ndër të tjerë figuron si bashkëpronare edhe bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit në 17/96 pjesë takuese.

20.7 Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e verifikuar.

¹⁷ Pasuria e këtij lloji e përfutur në katër sipërfaqe të ndryshme nga subjekti nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerit, babait të saj I.H, sikurse trajtohet në këto rezultate hetimi, ka pasur origjinën nga AMTP-ja nr.*** – administruar në dosjen e Komisionit, nga korrespondenca me ASHK/dega Elbasan.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2016, e ZVRPP-së Elbasan, e cila konfirmon se shtetasja M.H ka të regjistruar në bashkëpronësi (me 10 shtetas) pasurinë nr. ***, z. k. ***, bashkëlidhur kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit ullishtë me sip. 5.311 m², sipas AMTP-së, regjistruar me dëshmi trashëgimie, si dhe certifikata me datë regjistrimi 13.7.2016 dhe vendimi nr. ***, datë 22.9.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për lëshimin e dëshmisë trashëgimisë” (aneksi nr. 4/5, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁰ Referuar aneksit nr. 27, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹ Referuar aneksit nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së.

21. Ullishtë me sip. 9.149 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë Ullishta Z., Elbasan. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar: trashëgimi nga babai. Pjesa takuese: 17/96. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²².

21.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i Komisionit

21.2 Nga aktet e administruara rezulton se bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën për vitin 2016, në të njëjtën mënyrë sikurse ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

21.3 ASHK/Drejtoria Vendore Elbasan²³ konfirmon se znj. H, nëna e saj N.H dhe motra R.H (si trashëgimtarë të të ndjerit I.H) figurojnë bashkëpronarë me të tjerë në pasurinë e llojit ullishtë, me nr. pasurie ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, me sip. 9.149 m², ndodhur në z. k. ***, Elbasan. Kjo Drejtori ka bashkëngjitur edhe dokumentacionin mbështetës.

21.4 ZQRPP-ja²⁴, me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2017, 2.10.2017 dhe 12.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjet e ZVRPP-së Elbasan, me nr. *** prot., datë 23.8.2017, nr. *** prot., datë 22.9.2017 dhe nr. *** prot., datë 20.9.2017, të cilat konfirmojnë se shtetasja M.H ka të regjistruar në bashkëpronësi (me 10 shtetas të tjerë) pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 9.149 m², ndodhur në z. k. ***.

21.5 Gjithashtu, bashkëjetuesja e subjektit ka depozituar²⁵ kartelën përkatëse të pasurisë, certifikatën e regjistrimit të saj, me datë regjistrimi 13.7.2016, si dhe vendimin nr. ***, datë 22.9.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë”.

21.6 Nga verifikimi i dokumentacionit, Komisionit i rezultoi se pasuria objekt hetimi është regjistruar në emër të disa bashkëpronarëve, ku ndër të tjerë figuron si bashkëpronare edhe bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit në 17/96 pjesë takuese.

21.7 Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se përputhet deklarimi i bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e verifikuar.

22. Ullishtë me sip. 501 m², me nr. pasurie ***, z. k. **, me adresë Ullishta Z., Elbasan. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar: trashëgimi nga babai. Pjesa takuese: 17/96. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁶.

22.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i Komisionit

²² Shkresë nr. *** prot, datë 24.10.2016, e ZVRPP-së Elbasan, e cila konfirmon se shtetasja M.H ka të regjistruar në bashkëpronësi (me 10 shtetas) pasurinë nr. ***, z. k. ***, bashkëlidhur kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit ullishtë me sip. 9.149 m², sipas AMTP-së, e regjistruar me dëshmi trashëgimie, si dhe certifikata me datë regjistrimi 13.7.2016 dhe vendimi nr. ***, datë 22.9.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (aneksi nr. 4/5, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2017, e ZQRPP-së (aneksi nr. 27, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

²⁵ Referuar aneksit nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2016, e ZVRPP-së Elbasan, e cila konfirmon se shtetasja M.H ka të regjistruar në bashkëpronësi (me 10 shtetas) pasurinë nr. ***, z. k. ***, bashkëlidhur kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit ullishtë me sip. 501 m², sipas AMTP-së, e regjistruar me dëshmi trashëgimie, si dhe certifikata me datë regjistrimi 13.7.2016 dhe vendimi nr. ***, datë 22.9.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe vendimi nr. ***, datë 22.9.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (aneksi nr. 4/5, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

22.2 Nga aktet e administruara rezulton se bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën për vitin 2016, në të njëjtën mënyrë sikurse ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

22.3 ASHK/Drejtoria Vendore Elbasan²⁷ konfirmon se znj. H., nëna e saj N.H dhe motra R.H (si trashëgimtarë të të ndjerit I.H) figurojnë bashkëpronarë me të tjerë në pasurinë e llojit ullishtë, me nr. pasurie ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, me sip. 501 m², ndodhur në z. k. ***, Elbasan. Kjo drejtori ka bashkëngjitur edhe dokumentacionin mbështetës.

22.4 ZQRPP-ja²⁸, me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2017, 2.10.2017 dhe 12.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjet e ZVRPP-së Elbasan, me nr. *** prot., datë 23.8.2017, nr. *** prot., datë 22.9.2017 dhe nr. *** prot., datë 20.9.2017, të cilat konfirmojnë se shtetasja M.I.H ka të regjistruar në bashkëpronësi (me 10 shtetas të tjerë) pasurinë nr. ***, z. k. ***. Në seksionin e pronësisë, në kartelën e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit ullishtë me sip. 501 m², janë të pasqyruar emrat e 11 bashkëpronarëve.

22.5 Gjithashtu, bashkëjetuesja e subjektit ka depozituar²⁹ kartelën përkatëse të pasurisë, certifikatën e regjistrimit të saj, me datë regjistrimi 13.7.2016, si dhe vendimin nr. ***, datë 22.9.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë”.

22.6 Nga verifikimi i dokumentacionit, Komisionit i rezultoi se pasuria objekt hetimi është regjistruar në emër të disa bashkëpronarëve, ku ndër të tjerë figuron si bashkëpronare edhe bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit në 17/96 pjesë takuese.

22.7 Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e verifikuar.

23. Ullishtë me sip. 3.039 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë Ullishta Z., Elbasan. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar: trashëgimi nga babai. Pjesa takuese: 17/96. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁰.

23.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i Komisionit

23.2 Nga aktet e administruara rezulton se bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën për vitin 2016, në të njëjtën mënyrë sikurse ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

23.3 ASHK/Drejtoria Vendore Elbasan³¹ konfirmon se znj. H, nëna e saj N.H dhe motra R.H (si trashëgimtarë të të ndjerit I.H) figurojnë bashkëpronarë me të tjerë në pasurinë e llojit ullishtë, me nr. pasurie ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, me sip. 3.039 m², ndodhur në z. k. ***, Elbasan. Kjo drejtori ka bashkëngjitur edhe dokumentacionin mbështetës.

23.4 ZQRPP-ja³², me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2017, 2.10.2017 dhe 12.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjet e ZVRPP-së Elbasan, me nr. *** prot., datë 23.8.2017, nr. *** prot., datë 22.9.2017 dhe nr. 2807/635 prot., datë 20.9.2017, të cilat konfirmojnë se në emër të shtetasës M.H

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁸ Aneksi nr. 27, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁹ Referuar aneksit nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2016, e ZVRPP-së Elbasan, e cila konfirmon se shtetasja M.H ka të regjistruar në bashkëpronësi (me 10 shtetas) pasurinë nr. ***, z. k. ***, bashkëlidhur kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit ullishtë me sip. 3.039 m², sipas AMTP-së, e regjistruar me dëshmi trashëgimie, si dhe certifikata me datë regjistrimi 13.7.2016 dhe vendimi nr. ***, datë 22.9.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (aneksi nr. 4/5, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

³² Aneksi nr. 27, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

figuron e regjistruar pasuri në bashkëpronësi e llojit ullishtë me sip. 3.039 m², sipas kartelës së pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, regjistruar në datën 27.6.2016. Bashkëlidhur konfirmimit është kartela e pasurisë, harta treguese e regjistrimit, si dhe vendimi nr. ***, datë 22.9.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë”.

23.5 Gjithashtu, bashkëjetuesja e subjektit ka depozituar³³ kartelën përkatëse të pasurisë, certifikatën e regjistrimit të saj, me datë regjistrimi 13.7.2016, si dhe vendimin nr. ***, datë 22.9.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë”.

23.6 Nga verifikimi i dokumentacionit, Komisionit i rezultoi se pasuria objekt hetimi është regjistruar në emër të disa bashkëpronarëve, ku ndër të tjerë figuron si bashkëpronare edhe bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit në 17/96 pjesë takuese.

23.7 Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e verifikuar.

Deklarimi i pasurive të babait të subjektit të rivlerësimit

24. Apartament me sip. 92,7 m², shkalla ***, apartamenti ***, me adresë Y, rruga “****”, pallati “****”, Tiranë, blerë me kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2011. Vlera: 39.861 euro. Pjesa takuese: 50% me bashkëshorten. Burimi i krijimit: paguar 35.990 euro me këste, përkatësisht:

- Kësti i parë 10.000 euro, me mandatarkëtimin nr. ***, datë 19.12.2011;
- Kësti i dytë 9.330 euro, me mandatarkëtimin datë 24.11.2012;
- Kësti i tretë 9.330 euro, veprim në llogari derdhje *cash*, datë 25.5.2013, BKT;
- Kësti i katërt 7.330 euro, veprim në llogari derdhje *cash*, datë 25.11.2013, BKT;
- Pa paguar 3.871 euro. Shuma e parave të paguara është përfituar nga:
 - a. shitja e apartamentit me sip. 54,8 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë Lagjia Nr. ***, Kavajë, në vlerën 3.196.320 lekë. Apartamenti është përfituar në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Kavajë nr. ***, datë 30.8.1995, për marrjen e një apartamenti 1+1 dhe lidhjen e kontratës me Entin e Banesave;
 - b. shitja e pasurisë e llojit arë me sip. 3.500 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë B, Kavajë, nga vlera e shitjes 850.000 lekë është marrë nga bashkëshortja M.B si bashkëpronare e 1/5 pjesë shuma 150.000 lekë;
 - c. shitja e pasurisë e llojit arë me sip. 1.355 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë B, Kavajë, nga vlera e shitjes 1.000.000 lekë është marrë nga bashkëshortja M.B si bashkëpronare e 1/5 pjesë shuma 180.000 lekë;
 - d. të ardhurat nga pagat dhe kursimet e familjes.

Dokumentacioni ligjor:

- a. Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2011, e apartamentit me sip. 92,7 m²; mandatarkëtim nr. ***, datë 19.12.2011; mandatarkëtim datë 24.11.2012; veprim në llogari derdhje *cash*, datë 25.5.2013, BKT; veprim në llogari derdhje *cash*, datë 25.11.2013, BKT;
- b. Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2012, e apartamentit me sip. 54,8 m², në vlerën 3.196.320 lekë; certifikatë për vërtetim pronësie datë 5.1.2004; autorizim datë 26.1.1995, në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Kavajë nr. ***, datë 30.8.1995, për marrjen e një apartamenti 1+1 dhe lidhjen e kontratës me Entin e Banesave; fotokopje të librezës së pagesave të Entit të Banesave Kavajë, të paguar me këste nga data 26.10.2000

³³ Referuar aneksit nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së.

- deri më 3.9.2003, kohë në të cilën është likuiduar detyrimi; mandatarkëtimi nr. ***, datë 3.9.2003, të Entit të Banesave Kavajë, në shumën 215.257 dhe shuma totale që është paguar me këste është 286.040 lekë;
- c. Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2003, e pasurisë së llojit arë me sip. 3.500 m²;
 - d. Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2004, e pasurisë së llojit arë me sip. 1.355 m²;
 - e. Vërtetim burse nr. ***, datë 18.10.2016, e Shkollës së Magjistraturës;
 - f. Vërtetim page datë 14.10.2016, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
 - g. Vërtetim page nr. *** prot., datë 18.1.2017, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
 - h. Kthim përgjigjeje nr. ***, datë 21.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në lidhje me masën e pensionit dhe të pagave neto në vite;
 - i. Vërtetim datë 24.1.2017, i Bashkisë Kavajë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁴.

24.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar. ZVRPP Tiranë nuk e konfirmon, pasi është me kontratë porosie dhe nuk është i regjistruar.*

- Lidhur me transaksionet e konfirmuara nga DPPPP-ja, rezulton se janë në emër të babait të subjektit, i cili nuk ka pasur detyrimin ligjor për t'i deklaruar në deklaratat e interesave privatë ndër vite.

Hetimi i Komisionit

24.2 Ky apartament është deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* nga babai i subjektit, ndërsa nga subjekti është deklaruar si adresë banimi Y, rruga “****”, pallati “****”, shk. ***, ap. ***, Tiranë, në DPV-në e vitit 2014.

24.3 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në³⁵ nuk konfirmohet regjistrimi i pasurisë apartament në emrin e babait të subjektit të rivlerësimit.

24.3.i Komisioni e ka pyetur³⁶ subjektin lidhur me regjistrimin e kësaj pasurie, si dhe i ka kërkuar të depozitojë dokumentacion mbështetës. Subjekti në përgjigje ka sqaruar: *“...është nënshkruar kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2021, me palë*

³⁴ Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2011, për apartament nr. ***, me sip. 92.7 m², K, Tiranë, me palë investitori “E Studio” sh.p.k. dhe porositës XH.B, me vlerë 39.861 euro; mandatarkëtim nr. ***, datë 19.12.2011; mandatarkëtim datë 24.11.2012; derdhje *cash* datë 25.5.2013, në llogari në BKT; derdhje *cash* datë 25.11.2013, në llogari në BKT; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2012, me palë shitëse XH dhe M.B dhe blerës Z. dhe H.SH, për apartamentin me sip. 54,8 m², ndodhur në Kavajë, me çmim shitjeje 3.196.320 lekë. Bashkëlidhur certifikata e pronësisë datë 5.1.2004, autorizim i datës 26.1.1995, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak Kavajë nr. ***, datë 30.8.1995. Fotokopje e librezës së pagesave të Entit të Banesave Kavajë, paguar me këste nga data 26.10.2000 deri më 3.9.2003, si dhe mandatarkëtimi nr. ***, datë 3.9.2003, për shumën 213.257 lekë shtetasi XH.B, për likuidim kësti i fundit; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2003, me palë shitëse M.B (7 shtetas të tjerë) dhe blerës SH.Q, për pasurinë arë me sip. 3.500 m², në B, Kavajë, me çmim 850.000 lekë; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2004, me palë shitëse M.B (7 shtetas) dhe blerës N, S dhe H.K, për pasurisë e llojit arë me sip. 1.355 m², me çmim 1.000.000 lekë, si dhe prokura të posaçme, certifikata e pronësisë dhe harta treguese (aneks nr. 4/7, administruar në dosjen e ILDKPKI-së); vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës për pagesën e përfutur nga z. Arbër Berexha, në vlerën totale 1.020.000 lekë; vërtetim datë 14.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për pagën e përfutur nga z. Arbër Berexha, në vlerën totale 877.611 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 18.1.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për pagën e përfutur nga z. Arbër Berexha, në vlerën totale 4.957.994 lekë (aneks nr. 4/4, administruar në dosjen e ILDKPKI-së); kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në lidhje me masën e pensionit dhe të pagave neto në vite; vërtetim datë 24.1.2017, i Bashkisë Kavajë (aneks nr. 4/8, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021, e Komisionit, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁶ Me pyetësin nr. 2, datë 31.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

shitëse shoqëria “E Studio” dhe me palë blerëse XH.B, të pasurisë së llojit apartament me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, Tiranë”. Në mbështetje të deklaramit subjekti ka depozituar kontratën e shitjes, certifikatën e regjistrimit të pronësisë datë 13.7.2021 dhe kartelën e pasurisë së llojit apartament me nr. ***, z. k. ***, Tiranë, në emër të babait të tij XH.B.

24.4 FSHU-ja³⁷ informon se me gjeneralitetet XH.B, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. *** në instancën Tiranë. Lidhur me këtë kontratë rezulton se është hapur në datën 11.6.2014, me adresë Y, kabina “E Studio”, që duket se përputhet me pasurinë objekt vlerësimi.

24.5 UKT sh.a.³⁸ informon se në emër të shtetasit XH.A.B rezulton kontrata nr. *** për objektin me adresë rruga “***”, Tiranë, me status aktiv, për kategorinë e konsumatorëve familjarë. Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion edhe kontratën e porosisë datë 19.12.2011, të lidhur mes shoqërisë “E. Studio” sh.p.k. dhe babait të subjektit XH.B, për apartamentin me sip. 92,7 m² (sipërfaqe e përbashkët 9,2 m²), në vlerën 39.861 euro.

24.6 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament

24.6.1 Nga verifikimi i kryer rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer:

- Shitja e apartamentit me sip. 54,8 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë Lagjia Nr. ***, Kavajë, në vlerën 3.196.320 lekë. Apartamenti është përfituar në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Kavajë nr. ***, datë 30.8.1995, për marrjen e një apartamenti 1+1 dhe lidhjen e kontratës me Entin e Banesave.
- Shitja e pasurisë së llojit arë me sip. 3.500 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë B, Kavajë. Nga vlera e shitjes 850.000 lekë është marrë nga bashkëshortja M.B si bashkëpronare e 1/5 pjesë shuma 150.000 lekë.
- Shitja e pasurisë së llojit arë me sip. 1.355 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë B., Kavajë. Nga vlera e shitjes 1.000.000 lekë është marrë nga bashkëshortja M.B si bashkëpronare e 1/5 pjesë shuma 180.000 lekë.
- Të ardhurat nga pagat dhe kursimet e familjes.

24.6.2 Komisioni analizoi secilin burim krijimi, si më poshtë detajuar:

24.6.2.i Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament, subjekti ka depozituar kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2016, me palë shitëse XH dhe M.B dhe palë blerëse Z dhe H.SH, për apartamentin me sip. 54,8 m², ndodhur në Kavajë, me çmim shitjeje 3.196.320 lekë.

Komisioni i kërkoi³⁹ subjektit të rivlerësimit të depozitojë kontratën e blerjes së kësaj pasurie, si dhe të informojë mbi tatimin në burim të paguar, për të ardhurat e përfituara nga shitja e saj. Subjekti në përgjigje ka sqaruar se: “Për pasurinë apartament në qytetin e Kavajës, të shitur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2012, në vlerën 3.196.320 lekë, është paguar tatim në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja, në vlerën 29.369 lekë, sipas rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, ku tatimi për vitin 2011 ka qenë në vlerën 1%”.

a. Në mbështetje të deklaramit, subjekti ka depozituar dokumentacionin e marrë nga ASHK/Drejtoria Vendore Kavajë, për kontratën noteriale të shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2003, me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse XH.B dhe M. B

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁹ Me pyetësin nr. 2, datë 31.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

(prindërit e subjektit), me objekt “Blerja e apartamentit me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, Kavajë”, si dhe dokumentacionin për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

b. Nga dokumentacioni i administruar, Komisioni konstatoi se pasuria apartament është blerë nga EKB-ja në vitin 2003 në shumën 259.440 lekë dhe në vitin 2011 është kryer rivlerësimi i saj në vlerën 3.190.320 lekë. Detyrimi për t’u paguar për rivlerësimin e pasurisë ka qenë në shumën 29.369 lekë, si 1% e diferencës mes vlerës së rivlerësimit dhe blerjes, e cila rezultoi se është paguar. Meqenëse në vitin 2012 pasuria është shitur po në vlerën 3.196.320 lekë (sa vlera e rivlerësuar) babai i subjektit nuk ka pasur detyrim për pagesë tatimi mbi të ardhurat nga shitja, pasi diferenca është 0 (zero).

c. Nisur nga faktet e dala, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me deklarin dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

24.6.2.ii Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme e llojit arë me sip. 3.500 m², subjekti ka depozituar kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2003, me palë shitëse M.B (plus 7 shtetas të tjerë) dhe blerës SH.Q, në vlerën 850.000 lekë.

a. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se ASHK Kavajë⁴⁰ nuk konfirmon pasuri në emër të shtetases M.B (nëna e subjektit).

b. Rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se nga vlera e shitjes 850.000 lekë është marrë nga bashkëshortja M.B si bashkëpronare e 1/5 pjesë shuma 150.000 lekë. Komisioni konstatoi se nëna e subjektit është bashkëpronare me 7 familjarë të tjerë dhe, për pasojë, pjesa e saj takuese për këto të ardhura është 1/8 e vlerës së shitjes, konkretisht 106.250 lekë.

c. Subjekti në shpjegimet⁴¹ e tij ka sqaruar se sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 6.3.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me objekt “Lëshim dëshmi trashëgimie”, trashëgimtarët (ku përfshihet edhe nëna e subjektit) kanë përfutur të drejta dhe detyrime në pjesë takuese të ndryshme, sipas radhës së dëshmisë së trashëgimisë.

ç. Komisionit, nga verifikimi i vendimit gjyqësor, i rezultoi se qëndron shpjegimi i subjektit dhe se nëna e tij është trashëgimtare e prindërve të saj për çdo pasuri të trashëguar prej tyre, në pjesë takuese 1/5.

d. Subjekti ka depozituar⁴² mandatarkëtimin nr. ***, datë 1.9.2003, në vlerën 4.250 lekë, për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie. Komisionit i rezultoi se sipas legjislacionit të kohës⁴³ detyrimi ka qenë 0.5% e vlerës së shitjes.

dh. Për rrjedhojë, Komisioni në përlllogaritjet e kryera përfshiu si vlerë të përfutur nga kjo shitje shumën e deklaruar nga babai i subjektit.

24.6.2.iii Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme e llojit arë me sip. 1.355 m², subjekti ka depozituar kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2004, me palë shitëse M.B (plus 7 shtetas të tjerë) dhe blerës N, S. dhe H.K, për pasurinë e llojit arë me sip. 1.355 m², në vlerën 1.000.000 lekë.

a. Nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se ASHK Kavajë⁴⁴ nuk konfirmon pasuri në emër të shtetases M.B (nëna e subjektit).

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Pyetësor nr. 3, datë 23.11.2023 dhe dokumentacion mbështetës, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴² Me pyetësorin datë 30.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴³ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku për çmimin e shitjes së pasurisë së paluajtshme në vlerën 0-2.000.000 lekë, detyrimi tatimor është në masën 0.5% të çmimit të shitjes.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

b. Rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se nga vlera e shitjes 1.000.000 lekë është marrë nga bashkëshortja M.B si bashkëpronare e 1/5 pjesë shuma 180.000 lekë.

c. Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, konstatoi se nëna e subjektit është bashkëpronare edhe me 7 familjarë të tjerë dhe, për pasojë, pjesa e saj takuese për këto të ardhura është 1/8 e vlerës së shitjes, konkretisht 125.000 lekë.

ç. Edhe në këtë rast subjekti ka dhënë të njëjtin shpjegim si në rastin e trajtuar më sipër, pasi pasuritë janë përfiturar nëpërmjet së njëjtës dëshmi trashëgimie, duke identifikuar të njëjtën pjesë takuese në varësi të shkallës së trashëgimtarëve.

d. Subjekti ka depozituar⁴⁵ mandatarkëtimin nr. ***, datë 7.12.2004, në vlerën 5.000 lekë, për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie.

dh. Komisionit i rezultoi se sipas legjislacionit të kohës⁴⁶ detyrimi ka qenë 0.5% e vlerës së shitjes. Komisioni në përlllogaritjet e kryera ka përfshirë si vlerë të përfiturar nga kjo shitje shumën e deklaruar nga babai i subjektit.

24.6.2.iv Lidhur me të ardhurat nga pagat dhe kursimet e familjes

a. Lidhur me këtë burim krijimi të deklaruar, Komisioni i ka kërkuar⁴⁷ subjektit të rivlerësimit të depozitohet dokumentacioni i justifikues ligjor për të ardhurat dhe kursimet e familjes. Në përgjigje, subjekti ka depozituar dokumentacioni i justifikues⁴⁸ për të ardhurat e secilit prej anëtarëve të familjes.

b. Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar, përlllogariti të ardhurat nga punësimi dhe pensioni sipas vërtetimeve përkatëse. Për vitet që paga rezultoi të jetë kredituar në llogaritë bankare të secilit anëtar, Komisioni mori në konsideratë shumat e kredituara në llogaritë bankare.

24.7 Në lidhje me likuidimin e kësaj pasurie

24.7.1 Nga dokumentacioni i administruar Komisionit i rezultoi se në kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2011, mes shoqërisë “E. Studio” sh.p.k. dhe shtetasit XH.B (babai i subjektit), për blerje apartamenti me sip. 92,7 m², me adresë Tiranë, Komuna K, apartamenti nr. ***, shkalla nr. ***, kati ***, çmimi i kontratës është 39.861 euro (430 euro/m²), i cili do të likuidohet si më poshtë:

- kësti i parë 10.000 euro me lidhjen e kësaj kontrate;
- kësti i dytë 9.330 euro deri në datën 15.11.2012;
- kësti i tretë 9.330 euro deri në datën 15.5.2013;
- kësti i katërt 9.330 euro deri në datën 15.11.2013;
- kësti i fundit 1.871 euro, me dorëzimin e apartamentit në kuptimin me çelësa në dorë.

24.7.2 Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se pagesat janë kryer si më poshtë referuar:

⁴⁵ Me pyetësin datë 30.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku për çmimin e shitjes së pasurisë së paluajtshme në vlerën 0-2.000.000 lekë, detyrimi tatimor është në masën 0.5% të çmimit të shitjes.

⁴⁷ Me pyetësin nr. 2, datë 31.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁸ Vërtetim burse nr. ***, datë 18.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës; vërtetim page datë 14.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vërtetim page nr. ***prot., datë 18.1.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në lidhje me masën e pensionit dhe të pagave neto në vite; vërtetim datë 24.1.2017, i Bashkisë Kavajë, Sektori i Ndihmës Ekonomike.

Dokument	Datë	Përshkrim	Vlera në euro
Mandatarkëtimi nr. ***	19.12.2011	XH.B, pagesë kësti për blerje apartamenti	10,000
Mandatarkëtimi	24.11.2012	XH.B, likuidim kësti i radhës për blerje apartamenti	9,330
BKT ⁴⁹ (depozitim <i>cash</i>)	25.5.2013	A.B, derdhje në llogari të shoqërisë “E. Studio” sh.p.k., këst për blerje apartamenti	9,330
BKT (depozitim <i>cash</i>)	25.11.2013	A.B, derdh për shoqërinë “E. Studio” sh.p.k. likuidim kësti për blerje apartamenti	7,330
		TOTAL	35,990

24.7.3 Komisioni, nisur nga vlera e paguar prej 35.990 euro, e ka pyetur⁵⁰ subjektin nëse ishte paguar vlera e mbetur prej 3.871 euro dhe, nëse po, kur ishte likuiduar ajo. Në përgjigje subjekti ka sqaruar se: *“Kësti i fundit prej 3.871 euro për blerjen e apartamentit me nr. pasurie ****, zona kadastrale ***, Tiranë, është paguar në datën 6.7.2021, pagesë e dërguar nga vëllai im A.XH.B në datën 20.4.2021 nëpërmjet Western Union nga shteti i Gjermanisë, ku jeton dhe punon si i*** që nga tetori i vitit 2017 dhe në vazhdim. Po në të njëjtën ditë është nënshkruar kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2021, me palë shitëse shoqëria “E. Studio” dhe me palë blerëse XH.B, të pasurisë së llojit apartament me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, Tiranë”*. Subjekti në mbështetje të deklaramit ka depozituar dokumentacionin mbështetës⁵¹.

a. Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit të depozituar, nuk konstatoi problematika lidhur me pagesën e këstit të fundit të paguar për këtë pasuri në vitin 2021, me burim krijimi të deklaruar nga të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit.

24.8 Komisioni kreu analizën financiare për të parë mundësitë financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit për të investuar në pasurinë apartament për këstet e paguara gjatë periudhës 2011 – 2013, në shumën 35.990 euro. Analiza është kryer për secilin këst, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar, konkretisht u kryen përlllogaritjet financiare për: (i) këstin e parë datë 19.12.2011, në vlerën 10.000 euro, për periudhën 1994 – 19.12.2011; (ii) këstin e dytë datë 24.11.2012, në vlerën 9.330 euro, për periudhën 20.12.2011 – 24.11.2012; (iii) këstin e tretë datë 25.5.2013, në vlerën 9.330 euro, për periudhën 25.11.2012 – 25.5.2013; (iv) për këstin e katërt datë 25.11.2013, në vlerën 7.330 euro, për periudhën 26.5.2013 – 25.11.2013.

24.9 Nga përlllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor (për çdo pagesë kësti të referuar në pikën 24.8) Komisioni konstatoi se dukej se familja e subjektit të rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi në shumën 2.617.136 lekë të paguante këstin e parë dhe të katërt për blerjen e apartamentit, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës⁵² për të provuar të kundërtën e konstatimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

24.10 Subjekti i rivlerësimit ka kontestuar analizën financiare në lidhje me pagesën e parë të kryer në datën 19.12.2011, të nisur prej vitit 1994, e bërë 1 muaj pas emërimit të tij si prokuror. Subjekti ka pretenduar se kursimet për blerjen e apartamentit kanë filluar nga koha kur ai ka filluar të marrë

⁴⁹ Dy pagesat e kryera nëpërmjet sistemit bankar janë raportuar edhe në DPPPP.

⁵⁰ Me pyetësin nr. 2, datë 31.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵¹ Mandatarkëtim nr. ***, datë 6.7.2021, për pagesën e shumës 3.871 euro, si këst i fundit për apartamentin; vërtetimet e pagave të viteve 2017, 2018, 2019 e 2020 të vëllait A.XH.B në shtetin gjerman, të përkthyer dhe të noterizuar; mandat tërheqjeje i parave datë 20.4.2021 nga nëna M.B, të dërguar nëpërmjet Western Union nga vëllai A.XH.B.

⁵² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

pagën e parë të bursës nga Shkolla e Magjistraturës. Ai ka deklaruar se deri në këtë periudhë prindërit e tij nuk kanë pasur mundësi financiare të kursenin nga paga e tyre dhe se të gjitha të ardhurat që ata realizonin destinoheshin për përballimin e shpenzimeve të jetesës, ku ai dhe vëllai kanë ndjekur studimet dhe nuk kanë qenë në marrëdhënie pune deri në këtë kohë. Sipas subjektit, për këtë periudhë, vetëm të ardhurat nga shitja e të dyja tokave, gjithsej në shumën 330.000 lekë, kanë qenë kursimet e ruajtura nga prindërit e tij, të cilët nuk kanë qenë subjekte deklaruese në cilësinë e personit të lidhur në deklaratat periodike vjetore dhe nuk kanë pasur detyrimin të deklarojnë gjendje *cash* në banesë.

24.11 Subjekti ka parashtruar se ai nuk mund të rezultojë në një pamundësi financiare në datën e pagesës së kështit të parë në vlerën që ka rezultuar nga analiza, pasi ka tërhequr nga Raiffeisen Bank 66.000 lekë në datën 8.11.2011, 31.000 lekë dhe 344.700 lekë në datën 12.12.2011 dhe se një javë përpara se të kryhej pagesa ka tërhequr kursime në shumën 441.700 lekë që u përdorën për pagesën e kështit të parë të apartamentit. Po në të njëjtin vit të kryerjes së pagesës së kështit të parë, sqaron subjekti, në datën 25.4.2011 ka tërhequr shumën 140.000 lekë nga Raiffeisen Bank, që do të thotë se për pagimin e kështit të parë, përveç të ardhurave të prindërve, ka kontribuar edhe ai me të ardhurat nga bursa e Shkollës së Magjistraturës dhe paga. Subjekti ka depozituar *statement* të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 21.10.2016, të llogarisë rrjedhëse të bursës dhe pagës së tij.

24.12 Sipas subjektit, kjo balancë negative deri në datën 19.11.2011 nuk vjen nga pagesa e kështit të parë në shumën 10.000 euro, por vjen nga pamundësia për mbulimin e shpenzimeve të jetesës prej vitit 1994 dhe deri në momentin kur në familjen e tij ka filluar të kontribuojë financiarisht dhe ai/subjekti, ndaj analiza financiare për pagesën e kështit të parë duhet të fillojë nga momenti që ai ka arkëtuar pagën e parë nga bursa, që rezulton të jetë në fillim të muajit nëntor 2008, pra momenti kur në familje hyjnë 3 paga dhe lindin mundësitë për kursim.

24.13 Pamundësia financiare në muajin dhjetor 2011, sipas subjektit, nuk vjen si rrjedhojë e pagesës së apartamentit, por si rrjedhojë e mbulimit të shpenzimeve jetike gjatë viteve nga të ardhurat e krijuara nga prindërit. Subjekti ka parashtruar se referuar analizës financiare deri në fund të vitit 2010 rezulton se familja e tij paraqitet me balancë pozitive, e cila mbartet në vitin 2011 në shumën 518.915 lekë. Në fund të vitit 2011 analiza financiare paraqitet në shumën 133.256 lekë. Pagesa e kështit të parë për blerjen e apartamentit justifikohet me të ardhura të ligjshme.

24.14 Sipas subjektit, duke qenë se analiza financiare paraqitet me balancë negative deri në momentin e shtimit të të ardhurave të tij nga bursa, ai nuk ka përfshirë në analizë vlerën e të ardhurave që babai i tij ka deklaruar, të realizuara nga shitja e tokave, prej 330.000 lekësh.

24.15 Në vijim, subjekti ka kontestuar analizën financiare të Komisionit, duke pretenduar: (i) mospërfshirjen e shpenzimeve të udhëtimit në vitin 2009, në shumën 58.983 lekë, në përlllogaritjet financiare, pasi udhëtimi në datat 15-19 qershor 2009 ka qenë vizitë studimore, ku nuk ka pasur kosto personale. Lidhur me këtë pretendim, subjekti ka depozituar vërtetimin nr.*** prot., datë 21.12.2023, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, duke sqaruar se nëpërmjet tij “*Vërtetohet se në cilësinë e kandidatit për magjistratë kemi marrë pjesë në këtë aktivitet në kuadër të bashkëpunimit me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut*”; (ii) ndryshimin e vlerës së shpenzimit të transportit nga 98.909 lekë në 37.091 lekë, në analizën financiare të kështit të fundit, datë 25.11.2013.

24.16 Në vijim, subjekti ka parashtruar mbi kështet e tjera, të cilat paraqiten me balancë pozitive, duke sqaruar veç kështin e fundit, i cili paraqitet me një balancë negative në shumën -29.904 lekë (që është vlerë jomateriale), nga ku ka rezultuar se nga mbledhja aritmetike e të ardhurave të babait ka diferencë ndërmjet analizës në momentin e pagesës së kësteve me analizën financiare të çdo viti kalendarik, sikundër rezulton se vlera e të ardhurave të përfituara nga babai në çdo vit është

më e lartë se vlera e të ardhurave të përfituara dhe paraqitura deri në datën 25.11.2013. Në përfundim, subjekti pretendon se familja e tij ka pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të paguajë këstet e blerjes së apartamentit në datën e kryerjes së pagesës.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti në prapësime lidhur me këtë çështje, arsyeton si vijon:

24.17 Në lidhje me pretendimin e subjektit se mundësia për kursim e familjes së tij ka nisur në momentin kur ai ka filluar të marrë pagën e parë të bursës nga Shkolla e Magjistraturës, trupi gjykues vlerëson të marrë në konsideratë këtë pretendim, pasi në këtë çështje identifikohen fakte që vlerësohen sipas një logjike të arsyeshme dhe objektive, ku ka rezultuar e provuar se:

- i) kësti i parë për blerjen e apartamentit është paguar në një kohë që subjekti sapo ishte emëruar në detyrë, por burimet e përdorura për këtë këst datojnë kohë përpara emërimit të tij;
- ii) në pyetësorin nr. 2, kur subjekti është pyetur në lidhje me kursimet që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, ai ka përfshirë edhe të ardhurat nga puna e tij, pra kontributin e tij nga momenti i punësimit;
- iii) pamundësia financiare e prindërve të tij përpara vitit 2007, për të mbuluar shpenzimet, nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit kur ai jo vetëm që nuk ishte në detyrë, por ishte student, kohë gjithashtu kur nuk ishte blerë ende pasuria objekt vlerësimi;
- iv) prindërit e subjektit nuk kanë qenë subjekte deklaruese e, për rrjedhojë, nuk mund të përcaktohet koha e saktë se kur kanë filluar mundësitë e familjes për të krijuar kursimet e tyre.

24.17.1 Për të gjitha argumentet e mësipërme, trupi gjykues çmon se nisur nga fakti që familja e subjektit të rivlerësimit ka rezultuar në balancë negative deri në vitin 2007, nuk bën logjikë që kursimet e viteve pasardhëse të mbulojnë rezultatet negative të viteve paraardhëse. Për këtë shkak, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë fokusi i vlerësimit është te provueshmëria e burimit të krijimit të këstit të parë të pasurisë, atëherë përlllogaritja objektivisht i përgjigjet mundësisë së krijimit të kursimeve në vitet sa më afër blerjes së pasurisë. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se nga analiza financiare për periudhën nëntor 2008 – 19.12.2011, kur është kryer pagesa e këstit të parë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur mundësi financiare.

24.18 Lidhur me pretendimin e subjektit për mospërfshirjen e shpenzimeve të udhëtimit në vitin 2009, pasi udhëtimi në datat 15-19 qershor 2009 ka qenë vizitë studimore, trupi gjykues, duke konstatuar se me dokumentacionin e depozituar nga subjekti, vërtetim nr. *** prot., datë 21.12.2023, të Shkollës së Magjistraturës, provohet qëllimi i udhëtimit për vizitë studimore në këto data dhe mbulimi i shpenzimeve nga organizatorët, çmon se ky pretendim i subjektit është i drejtë dhe, për rrjedhojë, është rishikuar analiza financiare duke bërë zbritjet përkatëse për këtë shpenzim. Në lidhje me pretendimin e subjektit për korrigjimin e vlerës së shpenzuar për udhëtimet e tij drejt institucionit punëdhënës për analizën e kryer për pagesën e këstit të katërt, trupi gjykues konstatoi se ky pretendim qëndron dhe, për rrjedhojë, kreu saktësimin e tyre duke kryer llogaritjet për periudhën 26.5.2013 – 25.11.2013, e cila rezultoi në vlerën 37.091 lekë.

24.19 Pas vlerësimeve të trupit gjykues në raport me pretendimet e subjektit, duke mos konsideruar të ardhurat nga kontrata e dhurimit në vlerën 800.000 lekë, sipas arsyetimit dhe vlerësimeve të trajtuara më sipër, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu rilllogaritjet financiare, nga ku u konstatua se balancat në fund të çdo periudhe kanë ndryshuar dhe janë mbartur në periudhën pasardhëse kur kanë rezultuar pozitive. Kjo mbartje është kryer për sa kohë që prindërit e subjektit nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe nuk mund të përcaktohen kursimet e tyre *cash*.

24.20 Në përfundim, lidhur me 4 këstet e paguara për pasurinë apartament, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij janë në pamundësi financiare për periudhën 26.5.2013 – 25.11.2013, në shumën 718.271 lekë, për të paguar këstin e katërt, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

Nr.	Përshkrimi	1.11.2008 – 19.12.2011	20.12.2011 – 24.11.2012	25.11.2012 – 25.5.2013	26.5.2013 – 25.11.2013
1	TË ARDHURA	3,416,971	4,937,732	1,238,724	1,723,893
	Të ardhura nga paga babai	430,854	179,454	98,967	90,685
	Të ardhura nga paga nëna	938,005	288,014	170,306	160,367
	Të ardhura nga paga subjekti	2,048,112	795,298	428,229	429,527
	Të ardhura nga shitja e apartamentit Kavajë (25.1.2012)		3,196,320		
	Të ardhura nga interesat		46,083	105,573	49,180
	Të ardhura nga periudha e mëparshme		432,563	435,649	994,134
2	SHPENZIME	1,790,888	597,298	319,968	403,197
	Shpenzime jetese	1,730,520	516,354	282,048	282,048
	Shpenzime TIMS		12,944	7,011	84,058
	Shpenzime transporti subjekti	31,000	68,000	30,909	37,091
	Shpenzime rivlerësim pasuria apartament në Kavajë	29,368			
3	PASURI	1,193,520	3,904,785	(75,378)	2,038,966
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme				
	Blerje apartamenti Tiranë	1,381,600	1,304,054	1,316,090	1,027,373
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>(188,080)</i>	<i>2,600,731</i>	<i>(1,391,468)</i>	<i>1,011,593</i>
	DIFERENCA (1-2-3)	432,563	435,649	994,134	-718,271

25. Lidhur me konstatimin e Komisionit se nga përlloraritjet e kryera për periudhën 2010 – 2016 vetëm për subjektin e rivlerësimit, ku dukej se ky i fundit nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 77.641 lekë për vitin 2015, subjekti ka kontestuar analizën financiare për vitin 2015 dhe specifikisht ka pretenduar korigjimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, pasi në to janë përfshirë edhe shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortes së tij, me të cilën në vitin 2015 nuk ka lidhur martesë ligjore kur bashkëjetesa e tyre ka filluar në gusht të vitit 2016 dhe se shpenzimet e udhëtimit janë përballuar prej saj me të ardhurat nga paga dhe familja e origjinës.

25.1 Lidhur me të ardhurat nga pagat e bashkëshortes, subjekti ka deklaruar se ajo ka qenë e punësuar në vitet 2014 dhe 2015 në subjektin “K.K”, person fizik, me NUIS ***, konfirmuar nga ISSH-ja me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2021. Sipas subjektit, shpenzimet e udhëtimit për vitin 2015 nga 160.910 lekë duhet të llogariten në analizën financiare në 98.967 lekë. Gjithashtu, sipas subjektit, edhe në analizën financiare bashkë me prindërit ky zë duhet të ndryshohet, pasi bashkëshortja në vitin 2015 nuk ka pasur një ekonomi të përbashkët me subjektin.

25.2 Trupi gjykues çmon se ky pretendim duhet të merret në konsideratë, pasi nuk rezulton ndonjë e dhënë për bashkëjetesë të tyre në periudhën para muajit gusht 2016, fakt ky që gjithashtu përputhet edhe me deklarinimin e subjektit në pyetësorin standard, ku ai ka deklaruar shpenzimet vetjake lidhur me udhëtimet jashtë vendit, pa e përfshirë bashkëjetuesen, e cila është bërë pjesë e familjes prej gushtit të vitit 2016.

25.3 Pas rillogaritjeve të kryera, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për vitin 2015 nga - 77.641 lekë shkon në -15.698 lekë.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

26. Në analizën financiare të kryer gjatë hetimit mbi deklaratet periodike ndër vite të subjektit, pas përlogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, për periudhën 1994 – 2016 për gjithë familjen dhe për periudhën 2010 – 2016 vetëm për subjektin e rivlerësimit, Komisioni, përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor paraqiti/përfshiu të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlogaritja krahasimore e tyre është vlerësuar mjaftueshmëria e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

26.1 Në rezultatet e analizës financiare, në përfundim të procesit u konsideruan dhe u përpunuan të dhënat për pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin e kryerjes së investimit me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës (të përfitimit), të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe, në përgjigje të pyetësorëve, gjendja e likuiditeteve, shpenzimet jetike, shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, si dhe shpenzimet e transportit, të cilat u rishikuan kur ato rezultuan të bazuara mbi dokumentacion provues dhe u vlerësuan bindëse nga rrethanat dhe faktet e provuara. Për sa më sipër trajtuar, për çdo çështje specifike, trupi gjykues, në rezultatin financiar gjithëpërfshirës në të dyja situatat e prezantuara qoftë si i vetëm apo në përbërje me familjen, konstatoi se subjekti dhe personat e lidhur me të rezultojnë me balancë negative në shumën 718.271 lekë për të paguar këstin e katërt të pasurisë, si dhe në analizën e kryer vetëm për subjektin e rivlerësimit rezultoi një balancë negative në shumën 15.698 lekë për vitin 2015.

26.2 Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

27. Njëkohësisht Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit dhe shoqërisë “E. STUDIO” sh.p.k. me administrator J. Ç. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet punëdhënëse të subjektit, këto të fundit konfirmojnë⁵³ se nga verifikimi në lidhje me kallëzimet apo procedimet penale të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të jetë regjistruar asnjë material kallëzues apo procedim penal përkundrejt shoqërisë “E. STUDIO” sh.p.k. apo administratorit J.Ç.

27.1 Bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioni konstatoi se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

28. Komisioni hetoi gjithashtu në lidhje me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial në përfitimin e kësaj pasurie. Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011”. Sipas këtij udhëzimi rezultoi se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës, në zonën *** ku ndodhet pasuria e subjektit, është 60.000 lekë/m², sipërfaqe e shfrytëzueshme. Apartamenti i porositur nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2011 është me sip. 92,7 m², në vlerën 5.507.196 lekë⁵⁴. Komisionit, duke u bazuar në çmimet referuese, i rezultoi se vlera e apartamentit me çmimet e tregut është 5.562.000 lekë⁵⁵. Kjo vlerë rezultoi më e lartë edhe pse me një diferencë shumë të vogël, konkretisht 54.804 lekë, nga çmimi i blerjes së apartamentit nga

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 16.11.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

⁵⁴ 39.891euro e konvertuar me kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë, në datën e nënshkrimit të kontratës 19.12.2011.

⁵⁵ 92.7 m² x 60.000 lekë/m².

babai i subjektit. Për sa më sipër, bazuar në të dhënat e verifikuara trupi gjykues nuk konkludoi në ekzistencën e ndonjë trajtimi të mundshëm preferencial në blerjen e kësaj pasurie.

29. Komisioni hetoi edhe lidhur me deklarinimin e subjektit në pyetëtorin standard se ai dhe familjarët e tij pas shitjes së apartamentit në qytetin e Kavajës datë 25.1.2012 kishin jetuar deri në korrik të vitit 2014 në shtëpinë e dajës së tij XH.L, me adresë Lagjja Nr. ***, rruga “***”, banesë private, Kavajë.

i. Subjekti në mbështetje të deklarinimit të tij ka depozituar kontratën e shitjes së apartamentit në Kavajë, bashkëngjitur saj edhe certifikatën e pronësisë, kontratën e porosisë për blerjen e apartamentit në Tiranë, deklaratën dhe kartën italiane të identitetit të dajës së tij XH.L.

ii. Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, i rezultoi se duket se përputhet deklarinimi i subjektit me dokumentacionin e depozituar lidhur me porosinë e apartamentit në Tiranë dhe shitjen e pasurisë në qytetin e Kavajës.

iii. Subjekti, në pyetëtorin nr. 2, lidhur me banesën e përdorur për vitet 2012 – 2014 deklaroi: “Në lidhje me banesën e dajës sim, shtetasit XH.L, sqaroj se në bazë të dokumentacionit të marrë nga Drejtoria Vendore ASHK Kavajë rezulton se pronar i shtëpisë, në të cilën unë dhe familja ime kemi jetuar nga data 25.1.2012 deri në korrik të vitit 2014 ka qenë në pronësi të gjyshit tim R.H.L, sipas vërtetimit hipotekor të regjistrit hipotekor me nr. ***, datë 22.8.1959. Sipas vendimit nr. ***, datë 4.9.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është bërë çelja e trashëgimisë ligjore së shtetasve R dhe F.L (gjyshërit e mi), për të cilën janë caktuar si trashëgimtarë ligjorë M.B (nëna ime), H.T, XH.L, N.L, E.M, I.L, E.L, R.L, SH.I, L.Ç, V.B, H.P, V.L, DH.SH dhe M.K. Këtë banesë e posedojnë dajat e mi XH.L dhe i ndjeri A.L, për të cilin është çelur trashëgimia ligjore, ku trashëgimtarë ligjorë janë N.L, E.M, I.L dhe E.L. Për arsye emigrimi poseduesit e pasurisë nuk kanë bërë të mundur regjistrimin e pasurisë në emër të tyre”. Subjekti në përgjigje të pyetësorit ka depozituar dokumentacionin mbështetës.

iv. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar Komisionit i rezultoi se pasuria ka qenë e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, datë 22.8.1959, në emër të gjyshit të subjektit të rivlerësimit, të ndjerit R.L. Po sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 4.2.2009, pasuria është regjistruar në emër të bashkëpronarëve sipas listës përkatëse ku rezultoi si bashkëpronare nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. M.B, dhe vëllai i saj XH.L. Listimi i bashkëpronarëve përkon me trashëgimtarët e përcaktuar në vendimin nr. ***, datë 4.9.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, lidhur me çeljen e dëshmisë së trashëgimisë.

v. Nga aktet e cituara më sipër, Komisionit i rezultoi se në këtë pasuri ndër trashëgimtarët ligjorë ishte edhe nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. M.B, me 1/5 pjesë takuese.

vi. Në këto kushte, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me mosdeklarinimin e pjesës takuese nga nëna e tij, i cili deklaroi: “...Në vitin 2016, në kohën kur ka filluar procesi i Vetting-ut, kam kërkuar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë informacion për pasuritë e regjistruara në emrin tim dhe familjarëve të mi dhe, më konkretisht, për babain tim XH.B, për nënën time M.B dhe për vëllain tim A.B. Me shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2016, të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë më është kthyer përgjigje, sipas së cilës në emër të shtetasve XH.B, M.B, A.B dhe A.B nuk rezultojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme. Këtë shkresë unë e kam paraqitur në dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës Vetting datë 26.1.2017. Në komunikimin me nënën time M.B, ajo më ka thënë se nuk ka pasur informacion nëse ishte përfunduar apo jo procesi i regjistrimit të pronësisë në emër të vëllezërve të saj XH.L dhe A.L, të cilët e posedojnë këtë pronë dhe e kanë banesën e tyre. Gjithashtu, dua të sqaroj se në të gjitha shpjegimet që i kemi dhënë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kësaj prone i jemi referuar se është në pronësi të dajave të mi XH.L dhe A.L”.

vii. Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2016, të ZVRPP-së Kavajë.

viii. Trupi gjykues, në analizë të të dhënave të pasqyruara në aktet e administruara, konstatoi se pasuria rrjedh nga trashëgimia ligjore dhe, për rrjedhojë, e konsideron këtë pasaktësi pa pasojë në këtë proces.

Deklarimi i pasurive të nënës së subjektit të rivlerësimit

30. Gjendje cash në banesë me vlerë 700.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat dhe kursimet e familjes.

30.1 Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nga pagat dhe kursimet Komisioni i ka trajtuar më sipër ato dhe nuk i kanë rezultuar problematika.

30.2 Nga hetimi i Komisionit i ka rezultuar se nëna e subjektit të rivlerësimit ka çelur në vitin 2012 një depozitë në Credins Bank me vlerë fillestare 896.081 lekë, me burim krijimi të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë apartament në qytetin e Kavajës. Kjo depozitë ka gjeneruar interesa deri në vitin 2016 dhe në datën 26.11.2016 është tërhequr shuma 716.193 lekë prej nënës së subjektit. Komisioni kreu analizën financiare në vitin 2012 dhe nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me krijimin e kësaj depozite.

30.3 Pavarësisht kësaj, Komisioni e ka pyetur⁵⁶ subjektin lidhur me rrethin e familjarëve që kanë kontribuar në krijimin e kursimeve dhe, në përgjigje, ai ka deklaruar se ka qenë kontributi i të ardhurave nga paga dhe kursimet e tij si subjekt rivlerësimi, nëna dhe babai i tij. Komisioni ka kryer analizën financiare nga viti 2014 deri në momentin e depozitimit të deklaratës *Vetting*, pasi në fund të vitit 2013 analiza financiare ka rezultuar negative. Në analizë janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar dhe, më konkretisht:

i. Në zërin e shpenzimeve Komisioni ka përfshirë edhe vlerën 10.000 lekë si shpenzime qiraje, të rezultuara nga kontrata e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.3.2015, nënshkruar mes babait të subjektit të rivlerësimit, z. XH.B, dhe shtetasit N.B. Komisioni i ka kërkuar⁵⁷ shpjegime subjektit lidhur me këtë kontratë, nga ku ai ka sqaruar se kjo kontratë është nënshkruar prej babait të tij në kushtet e nevojës për të pasur një të tillë, si një nga dokumentet e kërkuara për të realizuar bashkimin familjar të prindërve me fëmijët e tyre. Subjekti ka depozituar certifikatat e përbërjes familjare ku, në datën 17.3.2015, ata rezultojnë të ndarë në trungje të ndryshme familjare (prindërit veç dhe fëmijët veç) dhe pas nënshkrimit të qirasë në datën 20.3.2015 rezulton se janë ribashkuar në të njëjtin trung familjar sikurse ishin më parë, si një familje e vetme.

ii. Lidhur me shpenzimet e mobilimit subjekti ka deklaruar: “...me mobilimin e apartamentit tonë është marrë babai im XH.B si kryefamiljar. Nga komunikimi me babain tim, ai më ka thënë se mobilimi i apartamentit është bërë i shtrirë ndër vite dhe me sa mban mend shpenzimet për mobilimin e apartamentit kanë shkuar rreth 600.000 lekë dhe një pjesë të mobilimit e kemi marrë nga apartamenti që kemi shitur. Ai nuk e mban mend periudhën e blerjes apo datën për çdo mobilim të kryer, shumën për secilën prej tyre dhe nuk ka të ruajtura fatura për mobilimin”.

Meqenëse familja ka filluar të jetojë në këtë apartament prej korrikut të vitit 2014, Komisioni ka vlerësuar që këtë shpenzim ta ndajë në shumën 400.000 lekë në vitin 2014 dhe 200.000 në vitin 2015. Vlera më e lartë është vendosur si e shpenzuar në vitin e parë, pasi presupozohet se shpenzimet më të larta kryhen në vitin e parë për një banesë të re dhe për ta bërë të përshtatshme për banim.

⁵⁶ Pyetësor nr. 3, datë 23.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Pyetësor nr. 3, datë 23.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

30.4 Nga analiza financiare trupi gjykues konstatoi se familja e subjektit të rivlerësimit kishte pasur mundësi financiare të kursente, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare për periudhën 2014 – 26.1.2017.

Deklarimi i pasurive të vëllait të subjektit të rivlerësimit

31. Rezultoi se vëllai i subjektit ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruara në emrin e tij. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2016, të ZVRPP-së Kavajë, e cila konfirmon se lidhur me shtetasit XH, M, A dhe A.B nuk rezultojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme.

31.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarami i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i Komisionit

31.2 Nga verifikimi përkatës rezultoi se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka plotësuar deklaratën *Vetting* dhe ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj.

31.3 FSHU-ja ka konfirmuar se me gjeneralitetet A.B, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë të furnizimit të energjisë elektrike nr. ***, në instancën Kavajë. Komisioni i kërkoi⁵⁸ shpjegime subjektit lidhur me këtë kontratë, i cili në përgjigje ka sqaruar: “...kontrata nr. *** me kod klienti *** i përket abonentit A.B, e hapur në datën 5.11.2004⁵⁹. Në vitin 2004, kohë në të cilën janë kryer veprime mbi këtë kontratë të furnizimit të energjisë elektrike, vëllai im A.XH.B, i datëlindjes 8.10.1989, ka qenë në moshën 15-vjeçare dhe nuk ka pasur zotësi për të vepruar dhe nuk mund të kryente veprime juridike. Shtetasi A.B që rezulton në këtë kontratë të furnizimit të energjisë elektrike me nr. *** është gjyshi im, i cili ka ndërruar jetë në datën 17.10.1987 sipas certifikatës së vdekjes datë 2.11.2023. Gjyshi im A.A.B ka pasur një banesë në Lagjen nr. ***, Kavajë, për të cilën është lidhur kjo kontratë e furnizimit të energjisë elektrike. Në dokumentacionin e marrë nga Drejtoria Vendore ASHK Kavajë rezulton një vërtetim pronësie, ku rezulton që kjo pronë ka qenë e gjyshërve të mi A.A.B dhe M.B.B, pas vdekjes të së cilës është çelur trashëgimia ligjore me vendimin nr. ***, datë 14.10.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ku rezultojnë si trashëgimtarë fëmijët e tyre S, XH, F, N, N dhe A.B. Pas çeljes së trashëgimisë ligjore, me kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.12.1997, dhuruesit S, XH, F, N dhe N.B pjesën e tyre takuese ia kanë dhuruar vëllait të tyre A.B, i cili sot rezulton pronar i kësaj prone”. Subjekti ka depozituar gjithashtu edhe dokumentacion mbështetës⁶⁰.

31.4 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në raport me paqartësitë e identifikuar, Komisioni i rezultoi se shtetasi A.XH.B nuk disponon pasuri të paluajtshme në emrin e tij dhe se në kohën e hapjes së kontratës së energjisë rezulton vetëm 15 vjeç sipas certifikatës përkatëse të gjendjes civile.

32. Komisionit, nga verifikimi i të gjithë korrespondencës me DPPShtetit për sistemin TIMS⁶¹, AMF-në⁶² dhe RNSH-në⁶³, nuk i rezultuan të dhëna dhe informacione të tjera përveçse atyre të konfirmuara dhe të deklaruara nga subjekti gjatë hetimit.

⁵⁸ Me pyetësin nr. 2, datë 31.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁹ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 9.11.2023 të FSHU-së, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 9.11.2023, të FSHU-së; certifikatë vdekjeje dhe certifikatë familjare datë 2.11.2023 të gjyshit të tij A.A.B; certifikatë personale dhe certifikatë familjare datë 7.11.2023 të vëllait të tij A.XH.B; dokumentacioni i marrë nga Drejtoria Vendore ASHK Kavajë për pronën e regjistruar në emër të xhaxhait të tij A.B.

⁶¹ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 17.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶² Referuar shkresës nr. *** prot., datë 26.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶³ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 12.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

Vlerësimi tërësor i pasurisë

33. Bazuar në konkluzionet më lart, për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në përfundimin se mungesa e burimeve të ligjshme në vlerat e konstatuara të referuara më sipër, bazuar në parimin e proporcionalitetit⁶⁴ dhe objektivitetit, nuk mund të përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për t'i dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

34. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017. me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arbër Berexha, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 8.8.2023, të KDZH-së.

Hetimi i Komisionit

34.1 Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

34.2 Pas kërkesës së Komisionit⁶⁵ për përditësimin e informacioneve, AKSIK-ja në datat 4.9.2023 dhe 20.9.2023 informon se nuk disponon të dhëna të përditësuara lidhur me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit.

34.3 Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

34.4 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Arbër Berexha ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

35. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁶⁴ Referuar jurisprudencës së Kolegjtit, vendimeve nr. 18/2021; nr. 26/2021, nr. 17/2022 dhe nr. 19/2022.

⁶⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

35.1 Raporti është mbështetur në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumentet ligjore⁶⁶ të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) të dhënat e dokumentet që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iv) 5 dosjet gjyqësore⁶⁷ të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (v) të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, pas të cilëve është konkluduar në: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

35.2 Raporti i vlerësimit profesional⁶⁸, në analizë të gjetjeve⁶⁹, si dhe bazuar në të gjitha burimet e informacioneve për subjektin e rivlerësimit, nuk ka evidentuar problematika në aspektin e aftësive profesionale, organizative, etikës dhe integritetit të tij.

35.3 Vlerësimet nga Prokurori i Përgjithshëm për periudhën 2014 – 2016

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga prokurori Arbër Berexha në kuadër të vetëdeklarimit rezulton një vlerësim i punës i bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016 për prokurorin Arbër Berexha në nivelin “shumë mirë”⁷⁰.

35.4 Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore – vlerësimet)

35.4.1 Sipas raportit, nga verifikimi në arkivin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit, prokurorit Arbër Berexha, nuk janë dhënë masa disiplinore.

35.4.2 Prokuroria e Përgjithshme⁷¹ dhe të gjitha prokuroritë pranë shkallës së parë kanë përcjellë informacion lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga verifikimi i të cilave nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë lidhur me procedime penale, *indicie* nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve, etj.

35.4.3 Analiza e gjetjeve⁷²

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Arbër Berexha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional, rezulton se ai ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota.

b) Arsyetimi ligjor

⁶⁶ Dokumenti 1/Vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***; dokumenti 2/Kërkesë për vleftësimin e arrestit; dokumenti 3/Diskutimi përfundimtar në përfundim të gjyqimit të çështjes penale nr. ***.

⁶⁷Dosja nr. 1 – kallëzim penal nr. ***, viti 2014 (vendosur mosfillimi i procedimit/akti – vendimi i mosfillimit); dosje nr. 2 – procedimi penal nr. *** (vendosur pushimi i procedimit penal/akti – vendimi i pushimit); dosje nr. 3 – procedimi penal nr. *** (vendosur pushimi i procedimit penal/akti – vendimi i pushimit); dosje nr. 4 – procedimi penal nr. *** (vendosur dërgimi për gjykim i procedimit penal/akti – kërkesë për gjykim); dosje nr. 5 – procedimi penal nr. *** (vendosur dërgimi për gjykim i procedimit penal/akti – kërkesë për gjykim).

⁶⁸ Për më shumë të dhëna e detaje mund t’i referoheni raportit të vlerësimit profesional të përgatitur nga KLP-ja, dokument i cili administrohet në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit.

⁶⁹ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73 – 76 të ligjit nr. 96/2016.

⁷⁰ Gjithashtu, nga subjekti i rivlerësimit janë depozituar disa certifikata trajnimi.

⁷¹ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 14.7.2020, administruar në dokumentacionin shoqëruar të raportit të vlerësimit profesional të KLP-së.

⁷² Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Arbër Berexha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokuror Arbër Berexha, shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit dhe në analizën e provave në përputhje me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Arbër Berexha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Duke iu referuar vërtetimit nr. ***, datë 24.6.2020 dhe listës së statistikave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vënë në dispozicion të Komisionit në procedurën e shortimit të dosjeve të datës 24.6.2020, konstatohet se janë 570 çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit së bashku me çështjet e pezulluara, marrë në shqyrtim për shortim 415 prej tyre. Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve, konstatohet se prokurori Arbër Berexha është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune duke treguar eficiencë në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore. Afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse. Në analizë të të dhënave konstatohet se subjekti Arbër Berexha ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Arbër Berexha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Arbër Berexha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Arbër Berexha, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Arbër Berexha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Arbër Berexha dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Arbër Berexha. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Arbër Berexha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Arbër Berexha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti, nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

C/1. Rivlerësimi profesional

36. Nga analizimi i të gjitha dokumenteve ligjore të administruara dhe akteve të hartuara nga subjekti i rivlerësimit, pas të cilëve është përgatitur edhe raporti përkatës, nuk u vërejtën problematika në lidhje me etikën, integritetin dhe paanësinë e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së tij funksionale.

37. Në vijim, në informacionin e përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷³ konfirmohet⁷⁴ se për subjektin e rivlerësimit:

a. Është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A.B, i cili ka pretenduar se është akuzuar pa të drejtë për kryerje të veprës penale “Njoftimi i rremë në organet e rendit”, parashikuar nga neni 272 i Kodit Penal, në kuadër të çështjes nr. ***, hetuar nga prokurori Arbër Berexha. Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka verifikuar aktet dhe faktin që çështja ishte në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka konkluduar se nuk kishte kompetenca për të ndikuar në vendimmarrjen e prokurorit, si dhe nuk kishte konstatuar asnjë element të figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal apo vepre tjetër penale. Mbi bazë të këtij arsyetimi është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 30.10.2015, lënë në fuqi nga Gjykata.

⁷³ Referuar raportit të vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

⁷⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.9.2020.

i. Komisioni, bazuar në dokumentacionin⁷⁵ e depozituar, konstatoi se shtetasi A.B ka pretenduar se është akuzuar pa të drejtë për kryerje të veprës penale “Njoftimi i rremë në organet e rendit”, parashikuar nga neni 272 i Kodit Penal, në kuadër të çështjes nr. ***, hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** të shtetasit A.B për “Shpërdorim detyre” nga subjekti i rivlerësimit. Nga hetimi u konstatua se subjekti i rivlerësimit me vendimin datë 2.9.2015 ka dërguar për gjykim çështjen penale nr. ***, datë 2.4.2015, në ngarkim të të pandehurit A.B, i akuzuar për veprën penale “Njoftim i rremë në organet e rendit”, parashikuar nga neni 272 i Kodit Penal.

ii. Komisioni i kërkoi⁷⁶ subjektit të qartësonte dhe dokumentonte statusin e çështjes penale nr. *** (deri aktualisht), të hetuar prej tij.

iii. Subjekti ka shpjeguar dhe dokumentuar se ai ka dërguar çështjen për gjykim dhe se pas kërkesave të përsëritura të shtetasit B, për zëvendësim prokurori në përfaqësimin e gjykimit, subjekti është zëvendësuar nga një tjetër prokuror. Nga dokumentacioni i administruar, Komisioni konstatoi se shtetasi A.B është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. ***, datë 9.11.2016, me gjobë në shumën 100.000 lekë. Ky vendim rezulton se ka marrë formë të prerë në datën 16.12.2016.

iv. Për këtë çështje, trupi gjykues nuk konstatoi problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

38. Nga të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme rezultoi se:

a. Është regjistruar praktika nr. ***, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A.B (e njëjta praktikë e trajtuar më sipër).

b. Është regjistruar praktika nr. *** mbi bazën e ankesës së shtetasit F.B. Ankuesi ka pretendime në lidhje me hetimet që ka kryer prokurori Arbër Berexha, të konsideruara si të njëanshme në lidhje me ngjarjen e datës 14.4.2015, të ndodhur në fshatin Sh., G., Elbasan, ku ishin përfshirë edhe djemtë e ankuesit. Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacionin e nevojshëm në lidhje me procedimin penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Praktika, thuhet në raport, është arkivuar.

i. Komisioni për këtë çështje i kërkoi subjektit⁷⁷ shpjegime dhe dokumentacion mbështetës.

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, si dhe ka depozituar kopje të plotë të fashikullit të procedimit penal nr. ***, viti 2015, kopje të vendimit të formës së prerë nr. ***, datë 30.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për të dënuarit A.B dhe V.B.

ii. Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar që i përket procedimit penal nr. ***, datë 4.5.2015, regjistruar në ngarkim të shtetasve A.B dhe V.B (nga të dhënat e fashikullit të akuzuarit rezultojnë të jenë fëmijët e denoncuesit), të akuzuar për veprat penale “Vjedhje”, “Shkatërrimi i pronës” dhe “Largimi nga vendi i aksidentit” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 134, 150 dhe 273 të Kodit Penal, procedim i cili ka përfunduar së hetuari në datën 28.9.2015⁷⁸, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka ndër marrë masat e duhura për kryerjen e hetimeve të nevojshme, përfshirë këtu kryerjen dhe administrimin e ekspertimit mjekoligjor, ekspertimit autoteknik etj. Rezultoi se mbi provat dhe arsyetimin e bërë subjekti ka urdhëruar në datën 27.7.2015 regjistrimin e personit të cilit i atribuohet vepra penale, si dhe ka dërguar në datën

⁷⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.9.0020, të Prokurorisë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në materialin shoqërues të gjendur në raportin profesional të subjektit të rivlerësimit.

⁷⁶ Me pyetësin nr. 3, datë 23.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁷ Me pyetësin nr. 2, datë 31.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁸ Çështja është referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan në datën 14.4.2015, sipas akteve të fashikullit penal, administruar në dosjen e Komisionit.

28.9.2015 për gjykim çështjen në ngarkim të të pandehurve A.B dhe V.B, akuzuar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës” kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 150 e 25 të Kodit Penal. Gjithashtu rezultoi se subjekti ka arsyetuar në kërkesën për gjykim edhe mbi akuzën e largimit nga vendi i aksidentit, bazuar në aktin e ekspertimit autoteknik, i cili nuk ka rezultuar në të dhëna për ndodhi të ndonjë aksidenti. Mbi këto konstatime trupi gjykues nuk konkludoi në ndonjë problematikë që të cenojë veprimtarinë e punës së tij në raport me ligjin e zbatueshëm, në kuadër të këtij vlerësimi.

c. Është regjistruar praktika nr. *** mbi bazën e ankesës së shtetasit A.E. Ankuesi ka kërkuar përjashtimin e prokurorit Arbër Berexha nga hetimi i çështjes për shkatërrim prone, që ishte regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në lidhje me koncesionin e hidrocentralit të Xh., si dhe ka kallëzuar disa gjyqtarë, prokurorë, funksionarë të administratës shtetërore, etj.

i. Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar materialin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për kompetencë dhe zgjidhje ligjore, duke njoftuar ankuesin dhe duke arkivuar praktikën. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar materialin kallëzues nr. ***, datë 6.3.2018, të cilin e ka dërguar për kompetencë lëndore pranë ish-Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, në datën 3.4.2018. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 20.12.2019, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186, 190, 248, 306, 319/ç, 259 dhe 333/a të Kodit Penal. Prokurori i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në përfundim të hetimeve ka konkluduar se nuk rezultonte në asnjë moment konsumimi i veprës penale të korrupsionit aktiv apo pasiv të gjyqtarëve apo prokurorëve, të cilët kanë shqyrtuar apo hetuar kallëzimet penale të iniciuara nga shtetasi A.E. Procedimi penal është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprat penale të parashikuara nga nenet 186, 190, 248, 306, 135 dhe 134/3 të Kodit Penal në lidhje me procedurat e ndjekura për koncesionin e hidrocentralit të Xh.

ii. Komisioni për këtë praktikë nga korrespondenca me SPAK-un ka administruar të njëjtin informacion. Ankesa e shtetasit A.E⁷⁹, regjistruar me praktikën nr. ***, është trajtuar në mënyrë të hollësishme në denoncimet e depozituara pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit.

Në lidhje me denoncimet e depozituara në Komision, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ku janë depozituar 6 denoncime⁸⁰ rezultoi si vijon:

39. Denoncimi⁸¹ i shtetasit A.E

39.1 Denoncuesi ankohet për disa subjekte rivlerësimi, për mosgjykim të drejtë bazuar në dokumentacion të falsifikuar, si dhe për mosfillimin e procesit të hetimit në lidhje me disa kallëzime penale të bëra në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Në denoncimin e depozituar denoncuesi ka sqaruar se problematika e tij është me shoqërinë “A” sh.p.k. dhe çdo subjekt rivlerësues pjesë të hetimit dhe gjyqimit, noter apo OPGJ, të cilët me veprimet e tyre të korruptuara kanë formuar një grup të strukturuar kriminal, kanë shkatërruar pronën e shtetit, familjen dhe anën ekonomiko-financiare të tij. Denoncuesi pretendon se problematika midis palëve është se me anë të mashtrimit dhe falsifikimit të dokumentacionit janë transferuar kuotat e shoqërisë “A” sh.p.k. dhe të koncesionit nga shtetasi A.E tek shtetasja L.H, për të cilën denoncuesi pretendon se i gjithë dokumentacioni i firmosur në emër të saj është kryer nga bashkëshorti I.R (H) me profesion noter. Ai pretendon se ky dokumentacion është përdorur në institucione shtetërore dhe private si: Ministria e Energjetikës, prokuroritë, gjykatat, noterët, etj. Në ankimin e

⁷⁹ I cili gjithashtu ka depozituar edhe denoncim pranë Komisionit.

⁸⁰ Edhe të përsëritur.

⁸¹ Nr. *** prot., datë 8.2.2018 dhe nr. *** prot., datë 12.2.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

tij denoncuesi bën me dije se për kallëzimin penal shkatërrim të pronës hidrocentrali Xh, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. ***, datë 28.5.2014, ka vendosur të pranojë kërkesë-ankesën e denoncuesit, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila ka lënë detyrë për Prokurorinë e Rrethit Elbasan, që të vazhdojë hetimet. Për subjektin e rivlerësimit denoncuesi pretendon se nuk ka kryer detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit për të vazhduar hetimin, por ka vendosur mosfillim të procedimit duke i konsideruar si të parashkruara veprat penale. Me kërkesën datë 12.2.2018, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, shtetasi A.E ka kërkuar përjashtimin nga hetimi të subjektit rivlerësues të çështjes penale mbi vjedhjen e pronës shtetërore, hidrocentralit Xh, Librazhd, nëpërmjet falsifikimeve e mashtrimit. Subjekti ka depozituar disa dokumente.

39.2 Për këtë çështje, Komisioni⁸² i kërkoi subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë hetimin e kryer, si dhe të qartësojë statusin aktual të çështjes.

i. Subjekti i rivlerësimit fillimisht ka sqaruar historikun e çështjes. Sipas kallëzuesit, në datën 25.9.2009 shtetasi I.H dhe bashkëshortja e tij L.H kanë prishur hidrocentralin dhe vaskat, duke shkatërruar totalisht pronën e tij. Për këtë veprim të tyre është njoftuar Komisioni i Policisë Elbasan dhe Inspektorati i Policisë Ndërtimore Elbasan dhe shtetasi A.E ka bërë kallëzim penal në atë kohë. Për këtë ngjarje të datës 25.9.2009 është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2009, ku Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin 3.2.2010 ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal, pasi hidrocentrali dhe vaskat e peshkut janë pronë shtetërore dhe i janë dhënë në përdorim shoqërisë koncesionare “A” sh.p.k me administrator L.H për një afat 30-vjeçar. Sipas vendimit të pushimit të datës 3.2.2010 për procedimin penal nr. ***, viti 2009, rezulton se prishja e objektit në fjalë është pjesë e marrëveshjes së koncesionit të lidhur dhe jo veprim i kundërligjshëm i kryer nga shoqëria “A” sh.p.k. Ngjarja për të cilën pretendon kallëzuesi A.E, ku janë prishur hidrocentrali dhe vaskat e peshkut, ka ndodhur në datën 25.9.2009 dhe shtetasi A.E për këtë ngjarje ka bërë përsëri kallëzim penal më 4.3.2014. Me vendimin e mosfillimit të datës 19.3.2014 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, viti 2014, me arsyetimin se duke qenë se për të njëjtin fakt organi i Prokurorisë me vendimin e pushimit të procedimit penal datë 3.2.2010 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2009, procedimi penal nuk duhet të fillojë, pasi ky fakt është hetuar një herë nga organi i Prokurorisë në kohën kur ka ndodhur ngjarja. Në nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale është sanksionuar parimi i gjësë së gjykuar ose ndalimi dy herë për të njëjtën vepër penale, ku parashikohet se: *“Askush nuk mund të gjykohej rishtas për të njëjtën vepër penale, për të cilën është gjykuar me vendim të formës së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes penale nga gjykata kompetente”*. Në rastin konkret jemi para parimit të gjësë së gjykuar, pasi kallëzimi i shtetasit A.E për shkatërrimin e hidrocentralit dhe vaskave të peshkut është hetuar një herë nga organi i Prokurorisë. Subjekti ka depozituar vendimin e mosfillimit të datës 19.3.2014 për mosfillimin si procedim penal të materialit kallëzues nr. ***, viti 2014, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal; vendimin nr. ***, datë 28.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; vendimin nr. ***, datë 14.7.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës. Subjekti ka shpjeguar se me vendimin e mosfillimit të datës 20.7.2015 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, viti 2014, në bazë të nenit 66, shkronja “c” e Kodit Penal dhe nenit 290, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Penale.

ii. Subjekti ka shpjeguar se ngjarja për të cilën pretendon kallëzuesi A.E, ku janë prishur hidrocentrali dhe vaskat e peshkut, ka ndodhur në datën 25.9.2009 dhe në bazë të nenit 66/c të Kodit Penal kanë kaluar më shumë se 5 vjet. Për këtë arsye nuk mund të ndiqet penalisht vepra penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, pasi kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale.

⁸² Me pyetësoin nr. 2, datë 31.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

iii. Lidhur me statusin e kësaj çështjeje subjekti ka shpjeguar se shtetasi A.E ka bërë ankim ndaj vendimit të mosfillimit të datës 20.7.2015 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. ***, datë 5.2.2018, ka vendosur rrëzimin e ankimit të ankuesit A.E si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka bërë ankim shtetasi A.E dhe me vendimin nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur: Ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 5.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe, më konkretisht, Pranimi i ankimit të kërkuarit A.E, duke shfuqizuar vendimin datë 20.7.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014, dhe urdhërimi i Prokurorisë të regjistrojë këtë procedim dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas detyrave të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Me urdhrin datë 9.11.2018 është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2018, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Po në të njëjtën datë, me deklarin për dhënien e pëlqimit për heqjen dorë datë 9.11.2018, drejtuar drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kam kërkuar zëvendësimin tim me një prokuror tjetër për hetimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, pasi shtetasi A.E ka kallëzuar një sërë shtetasish, ku ndërmjet tyre edhe persona të cilët mbajnë funksionin e gjyqtarit dhe prokurorit. Ndër këta të kallëzuar përmendet edhe emri i prokurorit Arbër Berexha. Me vendimin për zëvendësimin e prokurorit datë 9.11.2018 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur zëvendësimi i prokurorit Arbër Berexha me një prokuror tjetër për hetimin e këtij procedimi penal. Procedimi penal nr. ***, viti 2018, është hetuar nga një prokuror tjetër e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe pas hetimeve të kryera nga prokurorja e çështjes është kërkuar pushimi i çështjes penale. Me vendimin nr. ***, datë 29.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur: (i) Pranimi i kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (ii) Pushimi i çështjes penale nr. ***, viti 2018, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Shtetasi A.E ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi, i cili mori formë të prerë më 6.10.2021, pasi me vendimin nr. ***, datë 6.10.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 29.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila e ka pushuar çështjen penale për të njëjtin shkak ligjor, siç është parashkrimi i ndjekjes penale neni 66 i Kodit Penal, me të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të datës 20.7.2015 për mosfillimin si procedim penal të materialit kallëzues nr. ***, viti 2014.

iv. Subjekti ka depozituar: (a) vendimin nr.***, datë 5.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (b) vendimin nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës; (c) urdhër datë 9.11.2018 për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018; (ç) deklarin për dhënien e pëlqimit për heqjen dorë datë 9.11.2018; (d) vendimin për zëvendësimin e prokurorit datë 9.11.2018 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (dh) vendimin nr. ***, datë 29.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 6.10.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës.

v. Subjekti ka sqaruar se lidhur me kërkesën e shtetasit A.E, datë 12.2.2018, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, për përjashtimin e tij nga hetimi i çështjes penale mbi vjedhjen e pronës shtetërore, hidrocentralit Xh, Librazhd, nëpërmjet falsifikimeve e mashtrimit, nuk ka dijani për këtë kërkesë, pasi nuk është njohur me një kërkesë të tillë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në kohën që është bërë kërkesa datë 12.2.2018, kjo çështje nuk ka qenë në hetim, pasi me vendimin e datës 20.7.2015 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, viti 2014, dhe materiali kallëzues është regjistruar në datën 9.11.2018 si procedim penal me nr. ***, viti 2018.

vi. Nga analiza e dokumentacionit të administruar, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit pasi ka marrë për hetim materialin kallëzues nr. ***, viti 2014, ka vendosur në datën 19.3.2014,

mosfillimin e çështjes, me arsyetimin se duke qenë se për të njëjtin fakt organi i Prokurorisë me vendimin e pushimit të procedimit penal datë 3.2.2010 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2009, procedimi nuk duhet të fillojë, pasi ky fakt është hetuar një herë nga organi i Prokurorisë në kohën kur ka ndodhur ngjarja.

vii. Vendimi i mosfillimit rezulton i ankimuar dhe i prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 14.7.2015. Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan rezulton se vendimi i mosfillimit duhet të priset dhe të vijojnë hetimet. Referuar arsyetimit të vendimit, shkak për prishjen e tij duket se në vendimin e mëparshëm të vitit 2010 për pushimin e çështjes nuk është hetuar për shkatërrimin e vaskave të peshkut, pasi ky pretendim i shtetasit E. është paraqitur në këtë material kallëzues dhe jo më parë, pra sipas gjykatës nuk është një çështje e hetuar më parë.

viii. Gjykata ka arsyetuar në këtë mënyrë bazuar në vendimin nr. ***, datë 26.10.2004, të kryetarit të Këshillit të Qarkut të Komunës H, me të cilin ishte vendosur miratimi i studimit për shesh ndërtimin e vaskave të peshkut nga shtetasi A.E.

ix. Ndërkohë rezulton se edhe pse gjykata ka adresuar një hetim konkret nën një argument konkret, subjekti i rivlerësimit edhe pas kthimit të çështjes ka vendosur në datën 20.7.2015 (vetëm katër ditë pas hyrjes së dosjes në prokurori, sikurse e citon vetë subjekti këtë fakt në arsyetimin e vendimit të mosfillimit) mosfillimin pa kryer hetimin e lënë nga gjykata, por kësaj here nën argumentin se vepra penale për të cilën kallëzohej ishte parashkruar nën nenin 66 të Kodit Penal. Ky arsyetim ka ardhur për shkak se: (i) ngjarja për të cilën pretendon kallëzuesi “Shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal parashikon dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet; (ii) ngjarja ku janë prishur hidrocentrali dhe vaskat e peshkut ka ndodhur në datën 25.9.2009 dhe, për këtë fakt, shtetasi E. ka bërë kallëzim në datën 4.3.2014.

x. Subjekti i rivlerësimit ka referuar vendimmarrjen bazuar në nenin 66/c të Kodit Penal, ku parashikohet se nuk mund të bëhet ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar 5 vjet për krimet që parashikojnë dënim deri në 5 vjet burgim ose gjobë. Ky vendim i subjektit është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 2.11.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 5.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke shfuqizuar vendimin e prokurorisë për *mosfillimin e çështjes* dhe *duke urdhëruar Prokurorinë* ta regjistrojë këtë procedim dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas detyrave të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Në arsyetimin e saj Gjykata e Apelit shprehet se organi i Prokurorisë nuk mund të dispononte me vendim mosfillimi të procedimit penal, por ajo duhet të regjistronte çështjen dhe të kryente veprime hetimore, të cilat do të konsistonin në zgjidhjen e detyrave të lëna nga gjykata me vendimin e saj nr. ***, datë 28.5.2018, si dhe në marrjen e deklarimeve të kallëzuesit, pasi në kallëzimin e tij kallëzuesi ka ngritur pretendime edhe për konsumim të veprave të tjera penale nga personat e kallëzuar prej tij, të zgjeronte hetimin në lidhje me veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Vjedhje e pasurisë me pasoja të rënda” etj.

xi. Pas këtij momenti, subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me kallëzimin e radhës nga denoncuesi për subjektin dhe të tjerë prokurorë nën akuzën e shpërdorimit të detyrës, ka kërkuar dorëheqjen nga kjo çështje, e cila është pranuar dhe në vijim çështja është trajtuar nga një tjetër prokuror, ku edhe është kërkuar pushimi i saj.

39.3 Për sa më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit kishte vepruar në kundërshtim me vendimin e gjykatës, duke anashkaluar detyrat e lëna për t’u kryer, të cilat kanë rezultuar pas kontrollit gjyqësor të vendimit.

39.4 Në këto kushte, Komisioni⁸³ i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit, por edhe në raport me veprimet e kryera nga prokurori i radhës pavarësisht kërkesës për pushimin e çështjes.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

39.5 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në pretendimet e tij për këtë çështje ka deklaruar se me këto vendime Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Apelit Durrës nuk kanë urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, por kanë vendosur vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, e cila ndryshon nga urdhërimi i gjykatës për regjistrimin e procedimit penal.

39.6 Subjekti nën të njëjtin kontekst ka kundërshtuar gjithashtu edhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit Durrës, e cila në vendimin nr. ***, datë 2.11.2018, është shprehur: *“Gjykata e Apelit çmon se vendimi i prokurorit i datës 20.7.2015, me të cilin është vendosur “Mosfillimi procedimit penal, që i përket kallëzimit penal me nr. ***” është i gabuar, pasi vjen në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë nr. ***, datë 28.5.2014, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e tij nr. ***, datë 14.7.2015, dhe me të cilin është urdhëruar regjistrimi dhe vazhdimi i hetimeve paraprake në referim të nenit 292 të Kodit të Procedurës Penale (në fuqi në kohën e dhënies së vendimit)”*. (Faqet 3 dhe 4 të vendimit). Subjekti e vë theksin në dispozitivin e vendimit, ku nuk është vendosur regjistrimi i materialit kallëzues, por është vendosur vazhdimi i mëtejshëm i hetimeve.

39.7 Subjekti ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit se ka anashkaluar detyrat e lëna për t’u kryer duke pretenduar se në vendimet e gjykatave përkatësisht nr. ***, datë 28.5.2014 dhe nr. ***, datë 14.7.2015 nuk është lënë ndonjë detyrë për t’u kryer nga organi i Prokurorisë.

39.8 Subjekti ka konfirmuar edhe zëvendësimin e tij në këtë çështje fill pas regjistrimit të procedimit penal pas vendimit nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës, pasi shtetasi A.E kishte kallëzuar një sërë shtetasish, ndër ta edhe gjyqtarë e prokurorë, ndër të cilët përmendet edhe emri i tij. Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar disa dokumente⁸⁴.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

39.9 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, në raport me ligjin e zbatueshëm në këtë çështje objekt shqyrtimi, arsyeton si vijon:

39.10 Trupi gjykues vlerëson se, përpos mospërkimit të pretendimit të subjektit lidhur me tipologjinë urdhëruese të vendimit të gjykatës, duhet mbajtur në vëmendje fakti se sa është pasqyruar në arsyetimin e vendimit të gjykatës, ku qartësisht i referohet moshetimit të prokurorisë në vitin 2010, konkretisht vendimit të prokurorisë, datë 3.2.2010, dhe kësaj nuk evidentohet mosveprim i subjektit (i cili nuk ka kryer asnjë hetim), por vëren hetime të paplota pikërisht në vitin 2010, ndonëse prishet vendimi i subjektit për t’i hapur rrugën hetimit të munguar, sipas gjykatës në fjalë.

39.11 Duke iu referuar arsyetimit të vendimit nr.***, datë 28.5.2014, të gjykatës, duket se i vetmi argument që çoi gjykatën në shfuqizimin e vendimit ishte arritja në konkluzionin se organi procedues më parë nuk kishte kryer hetime për shkatërrimin e vaskave, fakt i dalë prej vetë përmbajtjes së vendimit të pushimit të organit procedues në vitin 2010.

⁸³ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁸⁴ Vendimi nr. ***, datë 28.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; vendimi nr. ***, datë 14.7.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës; vendimi nr. ***, datë 5.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vendimin nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës, ku rezulton se vetëm në vendimin e fundit nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës, janë lënë si detyrë kryerja e veprimeve hetimore nga organi i Prokurorisë, ndërsa në vendimet e mëparshme nuk janë lënë veprime hetimore për t’u kryer; urdhri datë 9.11.2018, për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018; vendimi për zëvendësimin e prokurorit datë 9.11.2018, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

39.12 Nga leximi i vendimit të përsëritur të subjektit të rivlerësimit, datë 20.7.2015, “Për Mosfillimin e materialit kallëzues”, duket se nuk është parashtruar ndonjë argument i ndryshëm mbi konstatimin e gjykatës, por është bërë verifikim nëse çështja tanimë ishte parashkruar. Referuar udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të personit që i atribuohet vepra penale” i ndryshuar, është parashikuar se: “...*gjatë periudhës 30-ditore prokurori kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Në këtë rast prokurori nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale*”.

39.13 Në këto kushte, Komisioni vëren se ndonëse subjekti, i gjendur përballë një kallëzimi të përsëritur mbi të njëjtat fakte e persona, kur më herët, në vitin 2010, për të njëjtin kallëzim ishte vendosur mosfillimi apo pushimi i hetimeve, duket se nuk mund të kryente veprime hetimore dhe as të rianalizonte *ipso jure* plotësinë apo jo të hetimeve të kolegëve të tij, për sa kohë ishte gjë e gjykuar. Nga ana tjetër, subjekti, i gjendur përballë një vendimi gjykate që urdhëronte kryerjen e hetimeve, duhej të zbatonte këtë të fundit pa kryer vetë vlerësime të mëtejshme, për sa kohë në këtë rast diskrecionit të tij, tashmë i ishte vendosur vlerësimi dhe urdhërimi i gjykatës.

39.14 Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se mospërmbushja e detyrës së lënë nga gjykata nga subjekti i rivlerësimit për një hetim shtesë/të plotë të çështjes (të pakryer në vitin 2010) duket se mbetet evidente dhe e provuar, për sa kohë vendimet e përsëritura të organit të akuzës janë shfuqizuar gjithashtu në mënyrë të përsëritur, çka duket se tregon mungesë efektiviteti të përfundimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, por edhe mungesë për të hetuar dhe vlerësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Në përfundim, trupi gjykues çmon se ndonëse subjekti shfaq mangësi në drejtim të aftësisë për të hetuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe pa zvarritje (që mund të shkaktojnë edhe parashkrimin e hetimit), mangësi kjo që në raport me ecurinë e këtij procesi, i cili duket disi kompleks, i nisur prej vitit 2009 dhe i mbyllur në vitin 2010 (nga subjekte të tjera) pa hetime të plota, dhe pastaj i rihapur në vitin 2014 dhe gjithsesi i finalizuar me pushim të saj po për parashkrim të veprës penale, pasqyron një problematikë që vlerësohet nga trupi gjykues si rast i kufizuar dhe i pamjaftueshëm për të cenuar kriterin profesional apo procesin në tërësi për këtë subjekt.

40. Denoncim⁸⁵ i shtetasit J.B

40.1 Shtetasi J.B ankohet se në datën 9.2.2018 ka depozituar një kallëzim penal për mashtrim dhe fshehje të pasurisë pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan për shtetasin A.B. Subjekti i rivlerësimit në datën 23.2.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 9.2.2018. Denoncuesi ka sqaruar se ai e ka ezauruar të drejtën ankimore. Denoncuesi në denoncimin e parashtruar pretendon se kanë kaluar 10 muaj nga vendimi i gjykatës dhe subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin, si dhe nuk jep asnjë informacion për zhvillimin e hetimeve. Denoncuesi nuk ka depozituar ndonjë dokument për të mbështetur shpjegimet e tij.

40.2 Komisioni për këtë çështje i kërkoi subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë të kundërtën e pretendimeve të denoncuesit, si dhe të qartësojë e dokumentojë statusin aktual të çështjes (duke depozituar çdo kërkim apo vendim të organit të akuzës, apo organeve të gjyqësorit).

40.3 Subjekti ka shpjeguar historikun e çështjes, si dhe statusin e saj. Subjekti ka konfirmuar se me vendimin datë 23.2.2018 është vendosur mosfillimi i procedimit penal të materialit hetimor nr. ***, viti 2018, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Nga ana e kallëzuesit J.B është ushtruar ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal të materialit hetimor nr.***, datë 23.2.2018. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 14.6.2018, ka vendosur

⁸⁵ Nr. *** prot., datë 21.5.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

rrëzimin e kërkesës së shtetasit J.B. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi J.B dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 19.7.2018 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit penal nr. ***, datë 14.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (i) Pranimin e kërkesës së kërkuetit J.B; (ii) Shfuqizimin e vendimit të datës 23.2.2018 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për mosfillimin e procedimit penal” në lidhje me materialin kallëzues nr. ***, viti 2018; (iii) Regjistrimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. *** dhe vijimin e hetimeve”. Subjekti ka listuar veprimet hetimore që duheshin kryer sipas vendimit të gjykatës.

40.4 Subjekti ka saktësuar të gjitha detyrat e kryera të cilat, nga verifikimi përkatës, Komisionit i rezultuan të kryera. Po ashtu, subjekti ka sqaruar edhe lidhur me vendimin e radhës mbi kërkimin e tij për pushimin e çështjes.

40.5 Pas kryerjes së veprimeve të lëna si detyrë nga Gjykata e Apelit Durrës, me kërkesën për pushimin e procedimit penal datë 25.7.2019, është kërkuar në gjykatë pushimi i procedimit penal nr. ***, viti 2018, për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

40.6 Me vendimin nr. ***, datë 10.1.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018.

40.6.1 Shtetasi J.B ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit Durrës, duke paraqitur pretendime të tjera të reja të paparashtruara më parë në organin e Prokurorisë. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 2.7.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 10.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vazhdimin e hetimeve sipas drejtimit të përcaktuar në pjesën arsyetuese. Nga organi i Prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Apelit, konkretisht: Këqyrja e faqes zyrtare e shoqërisë “A” sh.p.k.; administrimi i dokumentacionit nga shoqëria “N. M. D” sh.p.k.; administrimi i dokumentacionit nga shoqëria “I.” sh.p.k.; administrimi i dokumentacionit nga shoqëria “A” sh.p.k.; këqyrja e faqes *online* në sistemin multifunksional të ZRPP-së; janë ballafaquar shtetasit A.B dhe D.N; janë ballafaquar shtetasit J.B dhe A.B; është marrë deklaram shtetasit A.Ç; këqyrja dhe marrja e dokumenteve nga shtetasi A.B; këqyrja dhe marrja nga shtetasi J.B të një USB-je dhe një CD-je, ku kallëzuesi kishte regjistruar bisedën midis tij dhe shtetasit A.B; procesverbal transkriptimi i bisedës së datës 18.5.2020 midis shtetasve J.B dhe A.B. Pas kryerjes përsëri të veprimeve të kryera të lëna si detyrë nga Gjykata e Apelit Durrës, me kërkesën për pushimin e procedimit penal datë 27.11.2020, nga organi i Prokurorisë është kërkuar në gjykatë pushimi i procedimit penal nr. ***, viti 2018.

40.7 Me vendimin nr. ***, datë 28.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, për shkak se fakti nuk përbën dhe nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

40.8 Shtetasi J.B ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 24.1.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

40.9 Pretendimet e shtetasit J.B se ka pasur zvarritje të hetimeve nuk qëndrojnë, pasi të gjitha veprimet hetimore të lëna si detyrë dy herë nga Gjykata e Apelit Durrës janë kryer në kohë dhe në vazhdimësi.

40.10 Subjekti ka depozituar: (i) vendimin datë 23.2.2018 për mosfillimin e procedimit penal të materialit hetimor nr. ***, viti 2018; (ii) vendimin penal nr. ***, datë 14.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (iii) vendimin penal nr. ***, datë 19.7.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës; (iv) urdhrin datë 3.8.2018 për regjistrimin e procedimit penal; (v) kërkesën për pushimin

e procedimit penal datë 25.7.2019; (vi) vendimin penal nr. ***, datë 10.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (vii) vendimin penal nr. ***, datë 2.7.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës; (viii) kërkesën për pushimin e procedimit penal datë 27.11.2020; (ix) vendimin penal nr. ***, datë 28.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (x) vendimin penal nr. ***, datë 24.1.2022, të Gjykatës së Apelit Durrës.

40.11 Komisionit, nga shpjegimet e subjektit dhe dokumentacioni i administruar, i rezultoi se çështja penale është hetuar në mënyrë të përsëritur nga subjekti i rivlerësimit. Fillimisht, subjekti i rivlerësimit mbi materialin kallëzues nr. ***, ka vendosur mosfillimin e tij ndaj shtetasit B, i akuzuar për veprën penale “Mashtrimi”. Më tej, Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 19.7.2018, ka shfuqizuar vendimin e subjektit dhe e ka kthyer çështjen për të regjistruar procedimin penal dhe për të kryer disa veprime hetimore konkrete. Pas regjistrimit të procedimit penal nr. ***, subjekti ka kryer hetimet e përcaktuara nga gjykata dhe ka vendosur pushimin e procedimit penal. Përsëri mbi ankimin e kallëzuesit/denoncuesit, Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 2.7.2020, ka prishur çështjen dhe e ka kthyer atë për të tjera hetime, pasi kishte pasur kërkitime të reja nga ato të mëparshmet të prezantuara nga kallëzuesi, për t’u hetuar. Pas vijimit të hetimeve nga kthimi i çështjes, është kërkuar pushimi i saj, i cili edhe pas ankimeve ka mbetur në fuqi.

40.12 Komisioni, në analizë të dokumentacionit të administruar, sikurse ka konstatuar vendimi nr. ***, datë 19.7.2018, i Gjykatës së Apelit Durrës, me të cilin është vendosur “Ndryshimi i vendimit penal nr. ***, datë 14.6.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetimet e duhura dhe, për pasojë, duket se ka vepruar në kundërshtim me nenin 73/2, 3 të ligjit nr. 96/2016.

40.13 Gjithashtu, Komisioni, në gjendjen që ndodheshin aktet deri në dërgimin e rezultateve të hetimit i kërkoi subjektit të provonte me dokumentacion se në cilën fazë të hetimit apo gjykimit ishin paraqitur kërkesat e reja nga kallëzuesi, gjithnjë duke nisur pas regjistrimit të procedimit penal.

Për konstatimet e mësipërme Komisioni i kaloi subjektit⁸⁶ barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40.14 Subjekti, ndër të tjera, ka theksuar se çështja është trajtuar edhe më parë për veprën penale “Mashtrimi” dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan është marrë vendim mosfillimi për procedimin penal për materialin hetimor nr. ***, datë 30.9.2015. Subjekti ka qartësuar se në këtë rast kishte vlerësuar se nuk duhej të kryheshin hetime për këtë material hetimor për arsye se kallëzimi penal i bërë nga shtetasi J.B nuk përmbante elemente të veprës penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 Kodit Penal dhe as elementet e ndonjë veprë tjetër penale të parashikuar nga Kodi Penal, ndaj dhe me vendimin datë 23.2.2018 kishte vendosur mosfillimin si procedim penal të materialit hetimor nr. ***, vitit 2018, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Në shpjegimet e tij subjekti ka renditur gjithashtu edhe arsyet përkatëse që çuan në këtë vendimmarrje. Subjekti ka shpjeguar se edhe pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 28.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, për shkak se fakti nuk përbën dhe nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ai ka qartësuar statusin e çështjes duke konfirmuar se Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 24.1.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke cituar se po për të njëjtin shkak, ai me vendimin datë 23.2.2018 kishte vendosur mosfillimin si procedim penal të materialit hetimor

⁸⁶ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

nr. ***, viti 2018, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale që do të thotë se edhe pse ishin kryer të gjitha veprimet hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Apelit Durrës, ishte arritur në të njëjtin konkluzion, në pushimin e procedimit penal. Subjekti ka depozituar disa dokumente⁸⁷.

40.15 Subjekti, në lidhje me kërkesën e Komisionit për të provuar me dokumentacion se në cilën fazë të hetimit apo gjykimit ishin paraqitur kërkesat e reja nga kallëzuesi, ka parashtruar se kallëzuesi J.B i kishte paraqitur pretendimet e tij në seancën gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës, të cilat ishin parashtruar në vendimin nr. ***, datë 2.7.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe, më konkretisht, në faqet nr. 2 dhe 3 të vendimit, duke qartësuar se kërkesat e marra parasysht nga Gjykata e Apelit Durrës ishin lënë si detyrë për t'u kryer nga organi i Prokurorisë. Subjekti në shpjegime ka renditur kërkesat e reja, si dhe ka konfirmuar lënien e tyre si detyrë për t'u përmbushur nga oficeri i policisë gjyqësore. Subjekti ka depozituar: vendimin penal nr. ***, datë 2.7.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore datë 30.9.2020; vendimin penal nr. ***, datë 19.7.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore datë 20.9.2018 (si akte më të mëparshme në kohë), për të bërë krahasimin e pretendimeve të kallëzuesit B. me qëllim për të konstatuar pretendimet e reja (kërkesat e reja) të tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

40.16 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, por edhe nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, konstatoi se qëndrojnë argumentet e prezantuara nga subjekti, se kërkimet e reja të kallëzuesit ishin paraqitur në gjykatë, e cila për shkaqe e rrethana të reja që nuk vareshin nga subjekti, kërkoi vijimin e hetimeve e, për rrjedhojë, nuk konstaton problematika që cenojnë kriterin profesional të subjektit.

41. Denoncim⁸⁸ i shtetas M.D

41.1 Denoncuesja pretendon për shkelje të kryera në vendimmarrje nga prokurorë dhe gjyqtarë gjatë proceseve hetimore dhe gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

41.2 Denoncuesja ka parashtruar se ajo dhe shtetasi P.D në datën 19.10.2020 kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e cila me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2020, ka dërguar për kompetencë kallëzimin penal, me arsyetimin se nga përmbajtja e kallëzimit nuk ofrohet asnjë e dhënë për veprën penale “Korrupsioni”, përveç pretendimeve mbi kundërligjshmëri të vendimmarrjeve të prokurorëve dhe gjyqtarëve, si dhe procese të parregullta ligjore. Në adresë të Komisionit denoncuesja ka depozituar ankesën e saj ndaj subjektit të rivlerësimit për moskryerje hetimi dhe mosfillim të procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, viti 2020.

41.3 Shtetasja M. D i ka bashkëlidhur denoncimit disa dokumente⁸⁹.

41.4 Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, i rezultoi se konflikt për këtë çështje është bërë marrja e një huaje në shumën 25.000.000 lekë në vitin 2004 shtetas V.S nga shtetasi P.D. Çështja civile ka ndjekur rrugën gjyqësore. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me veprimet e subjektit të rivlerësimit,

⁸⁷ Procesverbal mbi këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 23.2.2018, vendim datë 12.11.2015 për mosfillimin e procedimit penal të materialit hetimor nr. ***, datë 30.9.2015.

⁸⁸ Nr. *** prot., datë 15.1.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁹ (i) Vendimin e mosfillimit të procedimit penal, datë 7.12.2020; (ii) Aktet e kspertimeve nr. ***, datë 16.9.2020 dhe nr. ***, datë 13.1.2020; (iii) shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2020, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Tiranë; (iv) kallëzimin penal të deleguar me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2020, nga SPAK-u në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan; (v) vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, datë 29.10.2013; (vi) kontratat e dhurimit, si dhe kartelën e pasurisë nr. ***.

por vërejtji se subjekti kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal⁹⁰ të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2020, në tejkallim të afatit 15-ditor të parashikuar nga ligji.

41.5 Komisioni i kërkoi subjektit⁹¹ të japë shpjegime lidhur me këtë konstatim, si dhe të dokumentojë statusin aktual të vendimit të mosfillimit të materialit kallëzues.

41.6 Subjekti në përgjigjen e dhënë ka sqaruar se vendimi për mosfillimin e procedimit penal, datë 7.12.2020, është marrë në përputhje me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, brenda afatit 15-ditor, afat i cili fillon nga data e regjistrimit të kallëzimit penal dhe, në rastin konkret, materiali kallëzues është regjistruar me nr. ***, datë 23.11.2020.

41.7 Në lidhje me këtë fakt, subjekti ka sqaruar se Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) me shkresën nr. *** prot./***, datë 27.10.2020, ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan kallëzimin penal të shtetasve M.D dhe P.D, e cila është bërë hyrje në sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan me nr. ***, datë 2.11.2020. Me kartelën shoqëruese të praktikës datë 2.11.2020, kallëzimi penal i është ngarkuar oficerës së policisë gjyqësore për të thirrur shtetasit M.D dhe P.D, me qëllim për t'i marrë kallëzim penal dhe deklaram në formën e kërkuar nga ligji, pasi kallëzimi i këtyre shtetasve ishte paraqitur me shkrim në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe nuk kishin bërë kallëzim penal para oficerit të policisë gjyqësore.

41.8 Në datën 16.11.2020, oficerja e policisë gjyqësore ka marrë kallëzimin penal dhe deklaramin shtetasve M.D dhe P.D dhe, me informacionin për referimin e veprës penale, datë 19.11.2020, oficerja e policisë gjyqësore ka referuar materialin kallëzues për vlerësim të mëtejshëm. Në datën 23.11.2020 është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, i cili është hedhur në short elektronik, ku është caktuar prokurori Arbër Berexha.

41.9 Vendimi për mosfillimin e procedimit penal, datë 7.12.2020, është marrë brenda afatit 15-ditor, në përputhje me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, për materialin kallëzues nr. ***, datë 23.11.2020, afat i cili fillon në këtë datë, në të cilën është caktuar me short elektronik prokuror i çështjes.

41.10 Shtetasi P.D ka bërë ankim ndaj vendimit të mosfillimit të datës 7.12.2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2021, ka vendosur rrëzimin e ankimit të ankuesit P.D.

41.11 Shtetasi P.D ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 18.10.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 23.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

41.12 Shtetasi P.D ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi P.D kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

41.13 Gjithashtu, shtetasit M.D dhe P.D kanë paraqitur ankesën nr. *** prot., datë 18.1.2021, në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e cila me vendimin nr. *** prot., datë 14.1.2022, ka vendosur arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga këta shtetas ndaj veprimtarisë së magjistratit Arbër Berexha, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, pasi sjellja apo veprimet e prokurorit Arbër Berexha nuk kanë shkaqe që të përbëjnë shkelje disiplinore sipas parashikimeve të bëra nga nenet 101, 102, 103 dhe 104 të

⁹⁰ Në bazë të nenit 290, paragrafi 1, shkronja “ç” dhe nenit 291⁹⁰ të Kodit të Procedurës Penale.

⁹¹ Me pyetësin nr. 2, administruar në dosjen e Komisionit.

ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Subjekti, për të mbështetur shpjegimet e tij, ka depozituar disa dokumente⁹².

41.14 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka provuar të kundërtën e kërkimit paraprak në rezultatet e hetimit administrativ dhe, për pasojë, nuk diktoi fakte apo rrethana që cenojnë vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

42. Denoncim⁹³ i shtetasit L.XH

42.1 Shtetasi L.XH ankohet se subjekti i rivlerësimit, duke vepruar në kundërshtim me ligjin, ka shkelur interesat e tij. Denoncuesi, në cilësinë e bashkëshortit të shtetasës SH.XH, ankohet se subjekti në kundërshtim me ligjin ka regjistruar një procedim penal për shtetasen XH, në bazë të një kallëzimi të shtetasit SH.P, me shtetësi zvicerane. Shtetasi SH.P pretendon se gjatë periudhës 3-mujore që shtetasja XH, bashkëshortja e z. XH, ka punuar si dado në familjen e tij në Zvicër, ka vjedhur bizhuteri me vlerë deri në 7.000 euro. Denoncuesi pretendon se kallëzimi është kryer në bazë të fjalëve të shtetasit SH.P, të pabazuara në fakte apo prova, dhe se në emër të bashkëshortes së tij nuk është bërë kallëzim në vendin ku ka ndodhur humbja e bizhuterive, në qytetin M./A., Zvicër. Denoncuesi sqaron se në maj të vitit 2022 dhe përreth 6 muaj subjekti i rivlerësimit ka kërkuar takim me të, por denoncuesi nuk ka pranuar. Në datën 25.10.2022 është kryer një kontroll në banesën e tij, por nuk janë gjetur bizhuteritë apo sendet në vlerën e pretenduar. Denoncuesi i ka bashkëlidhur ankimit edhe procesverbalin e mbajtur për kontrollin e kryer në banesën e tij.

42.2 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit⁹⁴ që në gjendjen që ndodhen të dhënat e këtij denoncimi, të shpjegojë dhe dokumentojë hetimet e kryera, si dhe të dokumentojë statusin aktual të çështjes.

42.3 Subjekti në përgjigjen e dhënë ka sqaruar: *“Në datën 4.5.2022, në orën 12:00, është paraqitur në Komisionin e Policisë Elbasan dhe ka bërë kallëzim penal shtetasi nga Kosova SH.P, i cili ka shpjeguar se banon në shtetin e Zvicrës, në qytetin A. dhe se tremujorin e fundit ka punësuar si dado për t’u kujdesur për fëmijët shtetasen shqiptare SH.XH, nga Elbasani. Ai kallëzon se kjo shtetase, përpara se të ikte nga Zvicra, ditën e fundit ka vjedhur nga shtëpia e SH disa bizhuteri floriri, që kapin afërsisht vlerën rreth 7000 euro. Është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi SH.P, i cili ka deklaruar se ditën e fundit e ka përcjellë personalisht deri te autobusët që nisëshin për Shqipëri shtetasen SH.XH. Ai ka sqaruar gjithashtu se, kur është kthyer në shtëpi, ka konstatuar së bashku me bashkëshorten e tij se mungonin disa bizhuteri floriri dhe se të dy dyshojnë se i ka marrë shtetasja shqiptare SH.XH, pasi nuk kishte mundësi që dikush tjetër të hynte në shtëpi dhe t’i merrte. Për këtë arsye, shtetasi SH.P ka deklaruar se e ka marrë disa herë në telefon shtetasen SH.XH dhe ajo nuk ka pranuar t’i përgjigjet apo të japë sqarime. Madje, SH deklaroi gjithashtu se në telefon i është përgjigjur bashkëshorti i shtetasës SH.XH, shtetasi L.XH, i cili e ka ofenduar rëndë. Kështu, i indinjuar, shtetasi SH.P ka ardhur në komisionin e policisë Elbasan për të bërë kallëzim për veprën penale”.*

42.4 Subjekti ka konfirmuar se me urdhrin datë 13.6.2022 është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2022, për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Gjatë hetimit

⁹² Kartela shoqëruese e praktikës, datë 2.11.2020; shkresë nr. *** prot./***, datë 27.10.2020, e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, së bashku me kallëzimin me shkrim të shtetasve M.D dhe P.D; fleta e shortit elektronik të sistemit cams.pp.gov.al, datë 23.11.2020; informacioni për referimin e veprës penale, datë 19.11.2020, e cila ka marrë numër kallëzimi nr. ***, datë 23.11.2020; procesverbale kallëzimi të veprës penale të shtetasve M.D dhe P.D; procesverbale për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale të shtetasve M.D dhe P.D (procesverbale deklarimi); vendimi për mosfillimin e procedimit penal, datë 7.12.2020, për materialin kallëzues nr. ***, datë 23.11.2020; vendimi nr. ***, datë 23.3.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; vendimi nr. *** prot., datë 14.1.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i dërguar për dijeni prokurorit Arbër Berexha me shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2022.

⁹³ Nr. *** prot., datë 3.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁴ Me pyetësin nr. 2, administruar në dosjen e Komisionit.

të këtij procedimi penal janë kryer këto veprime hetimore: (i) është bërë kërkesë në gjykatë për të kryer kontroll në banesën e shtetases SH.XH dhe me vendimin nr. ***, datë 25.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Elbasan, është vendosur lejimi i kontrollit të banesës së shtetases SH.XH; (ii) është kryer kontroll në banesën e shtetases SH.XH nga oficerët e policisë gjyqësore në Komisaratin e Policisë Elbasan, ku nuk janë gjetur sende apo prova materiale që i përkasin veprës penale; (iii) janë pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale shtetasi SH.XH dhe bashkëshorti i saj L.XH.

42.5 Në përfundim të hetimeve, me kërkesën për pushimin e procedimit penal datë 25.11.2022, nga organi i Prokurorisë është kërkuar në gjykatë pushimi i procedimit penal nr.***, viti 2022, për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, e cila është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Subjekti ka depozituar disa dokumente⁹⁵.

42.6 Komisionit, nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe analizimi i dokumentacionit të depozituar, i rezultoi se për një kohë relativisht të gjatë, që nga data e regjistrimit të procedimit penal 13.6.2022, nuk ishte kryer ndonjë veprim hetimor deri në datën 24.9.2022, kur dhe ishte bërë kërkesa për kryerjen e kontrollit të banesës së shtetases SH.XH dhe, për këtë shkak, në gjendjen që ndodheshin aktet⁹⁶, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

42.7 Lidhur me konstatimet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se moskryerja e veprimeve hetimore gjatë periudhës kohore 13.6.2022 – 24.9.2022 ka ndodhur për shkak të zëvendësimit të oficerit të policisë gjyqësore dhe për shkak të lejes vjetore në muajin gusht.

42.8 Subjekti ka sqaruar se pas muajit gusht, në dy javët e para të muajit shtator, trajtohen materialet hetimore dhe kallëzuese të ardhura në prokurori gjatë muajit gusht, që nuk janë trajtuar gjatë këtij muaji, të cilat duhet të regjistrohen ose të vendoset mosfillimi i procedimit penal brenda afatit 15-ditor nga data e fillimit të punës pas pushimeve vjetore, që përkon me datën 5 shtator të vitit 2022.

42.9 Subjekti i ka trajtuar këto shkaqe objektive, të pavarura prej tij, të cilat kanë shkaktuar moskryerjen e veprimeve hetimore gjatë kësaj periudhe kohore.

42.10 Në lidhje me afatin e hetimit, ai ka sqaruar se procedimi penal nr. *** i vitit 2022 nuk ka pasur të regjistruar emrin e një personi të cilit i atribuohet vepra penale apo një person nën hetim dhe për këtë procedim penal nuk ka pasur afate hetimi në bazë të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, duke shpjeguar se në këtë kuptim nuk është cenuar asnjë afat hetimi apo paraburgimi në procesin penal. Nën këto argumente, subjekti ka provuar se procedimi penal është administruar në mënyrë të rregullt dhe nuk ka pasur zvarritje të hetimeve nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti, për të mbështetur shpjegimet e tij, ka depozituar disa dokumente⁹⁷.

⁹⁵ Urdhër datë 13.6.2022 për regjistrimin e procedimit penal; kërkesë për kryerjen e kontrollit të banesës, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Elbasan; vendim nr. ***, datë 25.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Elbasan; procesverbal i kontrollit të vendeve, datë 25.10.2022; procesverbal deklarimi i shtetases SH.XH, datë 2.11.2022; procesverbal deklarimi i shtetasi L.XH, datë 2.11.2022; kërkesë për pushimin e procedimit penal, datë 25.11.2022.

⁹⁶ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁹⁷ Procesverbal për kallëzimin e veprës penale datë 4.5.2022, procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, datë 4.5.2022; informacion për referimin e veprës penale, datë 30.5.2022; shkresë nr. *** prot./(***) datë 2.6.2022, e Komisarimit të Policisë Elbasan; formular për trajtimet e materialeve kallëzuese, datë 6.6.2022; fleta e shortit elektronik të sistemit cams.pp.gov.al, datë 6.6.2022; urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore, datë 13.6.2022; vendimi për zëvendësimin e oficerit të policisë gjyqësore, datë 27.7.2022; vendimi nr. *****, datë 11.6.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Elbasan.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

42.11 Trupi gjykues i çmon bindëse shpjegimet e subjektit, të cilat gjithashtu janë mbështetur edhe në prova justifikuese dhe, për pasojë, nuk dikton problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të tij.

43. Denoncim⁹⁸ anonim

43.1 Denoncuesja saktëson se është e detyruar të bëjë denoncimin në anormalitet, për arsye se është punonjëse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ajo akuzon disa prokurorë dhe gjyqtarë, të cilët nuk meritojnë të jenë pjesë e sistemit të drejtësisë. Ndër shumë emra subjektsh rivlerësuese, ajo përmend edhe subjektin e rivlerësimit, duke pretenduar se ai ka ndihmuar haptas njerëzit e E.T në universitet. Denoncuesja nuk e mbështet denoncimin e saj në asnjë fakt apo rrethanë.

43.2 Komisioni vlerësoi se denoncimi nuk përmban informacion që identifikon fakte e rrethana për t'u shqyrtuar sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

44. Denoncim⁹⁹ i shtetasit A.E

44.1 Shtetasi A.E ka depozituar në prokurori kallëzimin penal nr. *** për kryerjen e veprimeve arbitrare nga punonjësit e rendit publik të Komisarariatit të Policisë G.

44.2 Denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit për vendimin e mosfillimit të procedimit penal. Në denoncimin e tij, denoncuesi pretendon se në vitin 2012, në ambientet e biznesit të tij (bar-kafe), është dhunuar psikologjikisht dhe fizikisht nga punonjësit e rendit publik të Komisarariatit të Policisë G. për arsyen e moszbatimit të VKM-së nr. 587, datë 7.7.2010, të Këshillit të Ministrave "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike". Denoncuesi pretendon se në dhjetor të vitit 2012, gjatë kontaktit me policinë, polici D.T e ka qëlluar me grusht. Edhe pse ai ka vajtur në Komisariatin e Policisë G atë natë, nuk i kanë regjistruar kallëzim penal, për këtë arsye është drejtuar në Prokurorinë e Rrethit Elbasan, ku ka bërë kallëzim dhe është regjistruar procedimi penal. Denoncuesi sqaron se çështja është pushuar nga Prokuroria për mungesë provueshmërie. Ai pretendon se dhuna psikologjike ndaj tij është përsëritur në vazhdim, duke sjellë shqetësime në biznes, familje dhe dëmtim të shëndetit mendor, për të cilin edhe është mjekuar herë pas here. Në vitin 2018 ka ndodhur një konfrontim verbal dhe fizik mes tij dhe punonjësve të policisë në detyrë, D.T, A.Ç, L.M dhe T.T. Në ambientet e Komisarariatit, denoncuesi sqaron se është dhunuar fizikisht në mënyrë barbare, ku i kanë marrë dy celularët dhe kanë fshirë çdo provë të regjistruar kundër tyre. Nga dhimbjet ka kërkuar ta dërgonin në spital për ndihmë mjekësore, por ata e kanë dërguar në Drejtorinë e Policisë Elbasan, ku një mjek i ka bërë dy injeksione dhe ka rënë në gjumë. Ditën e nesërme ka dhënë dëshmi të detajuar tek prokurorja E.T dhe gjykata, pas 5 ditësh arresti, e ka lënë të lirë me masë sigurie "Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore". Denoncuesi deklaroi se nuk ka bërë kallëzim në atë kohë, sepse e ka lënë për një moment të dytë, pasi të sqaronte pozitën e tij ligjore, meqenëse ishte në përgjegjësi penale.

44.3 Komisioni administroi kopje të fashikullit¹⁰⁰ të procedimit penal nr. ***, përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

44.4 Nga të dhënat në fashikullin penal vërehet se me vendimin e datës 9.6.2022¹⁰¹ prokurorja Elveta Stafa është zëvendësuar nga subjekti i rivlerësimit.

⁹⁸ Nr. *** prot., datë 14.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁹ Nr. *** prot., datë 8.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁰ Me shkresën nr. ***, datë 12.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰¹ Procesverbal nr. ***, datë 9.6.2022, administruar në fashikullin e procedimit penal nr. ***, si dhe në dosjen e Komisionit.

44.5 Nga të dhënat e pasqyruara në fashikullin e procedimit penal vihet re se subjekti i rivlerësimit ka nisur hetimin për procedimin penal nr. *** në datën 9.6.2022. Në procedurën e hetimit është caktuar oficeri i policisë gjyqësore P.C, i cili ka qenë në procesin e hetimit për këtë procedim penal dhe kur çështja hetohej nga prokuroja e mëparshme, ndaj vihen re që disa procedura për hetimin e çështjes janë bërë më parë se subjekti të merrte këtë çështje.

44.6 Më tej janë konstatuar edhe disa veprime hetimore të kryera si në datën 16.11.2022, kur edhe është mbajtur procesverbal për këqyrjen e CD-ve me pamjet filmike të marra nga aparatet telefonike të shtetasit A. E, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna për ngjarjen; janë pyetur në cilësinë e personave që tregojnë rrethana të hetimit edhe mjekët; është administruar dokumentacion mjekësor që i përket shtetasit A. E; është përpiluar vendim për caktimin e ekspertit dhe kryerje ekspertimi mjekoligjor në datën 11.11.2021 për shtetasin A. E, dërguar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë etj.

44.7 Bazuar në veprimet hetimore të bëra, shqyrtimin e depozitimin e fakteve dhe provave të mbledhura e të shtuara në dosje, në datën 27.2.2023 subjekti i rivlerësimit ka njoftuar përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2021.

44.8 Në datën 27.2.2023, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 328/1¹⁰², shkronja “dh” dhe nenin 329/a¹⁰³ të Kodit të Procedurës Penale, i drejton kërkesën për pushimin e çështjes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në këtë kërkesë, subjekti shprehet se ka hetuar mbi detyrat e lëna nga Gjykata në vendimin nr. ***, datë 13.4.2021. Shtetasi A. E për ngjarjen e vitit 2018 ka pranuar vetë se ka kundërshtuar forcat e rendit dhe se është fajtor, vërtetuar me vendimin nr. ***, datë 9.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në të cilin është vlerësuar si i ligjshëm arresti dhe është caktuar ndaj tij masa e sigurisë “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”. Pas hetimit penal, në datën 2.4.2019 është lidhur marrëveshje “Për pranimin e fajësisë nga i pandehuri A.E në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2018”.

44.9 Lidhur me pretendimin e denoncuesit për një proces të zvarritur hetimor, nisur nga kronologjia e procesit, vihet re se në këtë procedim penal në hetim janë zëvendësuar tre prokurorë dhe subjekti i rivlerësimit ka kryer dhe përfunduar hetimin e procedimit penal për rreth 8 muaj e 18 ditë (nga data 9.6.2022 deri në datën 27.2.2023).

44.10 Për sa më sipër, nisur nga dokumentacioni i depozituar, Komisionit i rezultoi se pjesa më e madhe e hetimit ishte bërë para se subjekti i rivlerësimit të kryente veprime hetimore për procedimin penal nr. **. Dukej se koha që subjekti kishte marrë për kryerjen e veprimeve në raport me vijimin e procesit hetimor, ishte përdorur vetëm për tri veprime hetimore, të cilat datonin pas 5 muajsh nga marrja e çështjes (pra, nga qershori deri në nëntor 2022) dhe, po ashtu, edhe koha e shfrytëzuar për përfundimin e hetimeve, pa u konstatuar ndonjë veprim i kryer pas datës 1.12.2022, dukej të ishte relativisht e gjatë – 3 muaj.

44.11 Në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të dokumentojë mbi këto konstatime.

¹⁰² Neni 328/1, shkronja “dh” e Kodit të Procedurës Penale – Pushimi i akuzës ose çështjes: “1) Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai”.

¹⁰³ Neni 329/a i Kodit të Procedurës Penale – Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes (shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017): “1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 328 të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes; 2. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq; 3. Kërkesës së prokurorit i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër; 4. Kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ata kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre”.

44.12 Subjekti në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se në datën 30.4.2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, procedim i cili ishte hetuar nga një prokuror tjetër deri në datën 9.6.2022, datë në të cilën ishte caktuar prokurori Arbër Berexha për hetimin e këtij procedimi penal. Pas përfundimit të hetimeve, me kërkesën datë 27.2.2023 për pushimin e procedimit penal të paraqitur në Gjykatë, ishte kërkuar pushimi i procedimit penal nr. 517 të vitit 2021, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Subjekti ka konfirmuar se kohëzgjatja e hetimit të këtij procedimi penal, nga data 9.6.2022 (data e caktimit të prokurorit Arbër Berexha për hetimin e procedimit penal) deri më 27.2.2023 (data e kërkesës për pushimin e procedimit penal), ishte rreth 8 muaj, periudhë në të cilën përfshihet edhe muaji gusht, ku prokurorët nuk janë në punë, pasi korrespondon me lejen vjetore. Subjekti ka deklaruar se gjatë kësaj kohe ishin studiuar aktet e procedimit penal, përcaktuar dhe kryer veprimet hetimore, administruar shkresat e përgjigjeve nga institucionet e ndryshme, si dhe ishin përfunduar hetimet.

44.13 Në lidhje me konstatimin se nuk rezultonte ndonjë vendim për zgjatje të afateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se për këtë procedim penal nuk është regjistruar ndonjë emër si person që i atribuohet vepra penale (neni 287 i Kodit të Procedurës Penale), datë në të cilën fillon afati i hetimit. Për këtë arsye, në bazë të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, për këtë procedim penal nuk ka afate hetimi, derisa nuk është regjistruar ndonjë emër si person që i atribuohet vepra penale. Subjekti ka referuar përmbajtjen e nenit 323, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale “Afati i hetimeve paraprake”, ku parashikohet: *“Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjatë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 75/a të këtij Kodi”*.

44.14 Ndërsa sa i përket konstatimit se veprimet hetimore janë ezauruar nga të tjerë prokurorë deri në kohën e marrjes së çështjes nga subjekti i rivlerësimit, subjekti ka kundërshtuar, duke renditur konkretisht dhjetë veprimet hetimore të kryera prej tij.

44.15 Subjekti ka deklaruar se duke pasur parasysh sa më sipër, procedimi penal është administruar në mënyrë të rregullt dhe nuk ka pasur zvarritje të hetimeve, por ato janë kryer në kohë dhe në vazhdimësi.

44.16 Në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me aktet e administruara në fashikullin penal (sipas gjendjes së akteve të ndodhura deri aktualisht) dhe veprimet hetimore të kryera, të deklaruara nga subjekti në shpjegimet e tij, dukej se nuk ishin kryer veprime hetimore nga muaji qershor 2022 deri në nëntor të vitit 2022 dhe, po ashtu, edhe për rreth 3 muaj nga veprimi i fundit deri në përfundimin e hetimeve, datë 27.2.2023.

44.17 Në këto kushte, Komisioni¹⁰⁴ i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

44.18 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në shpjegimet e tij për këtë çështje objekt shqyrtimi, ka pranuar vonesën e diktuar nga Komisioni për mosndërmarrje të ndonjë veprimi hetimor prej muajit qershor 2022 deri në nëntor të po këtij viti, porse ka argumentuar se ky fakt ka ardhur për shkak të zëvendësimit të prokurorit në këtë çështje. Më konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, datë 9.6.2022, është vendosur zëvendësimi i prokurores E.S (M) me prokurorin Arbër Berexha. Subjekti ka deklaruar se në atë kohë ai kishte

¹⁰⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

marrë disa procedime penale dhe disa çështje në gjykim nga prokurorja E.S (M), e cila me vendimin e Komisionit është shkarkuar nga detyra.

44.19 Subjekti ka kërkuar nga Komisioni që për periudhën kohore për të cilën bëhet fjalë të merret parasysh edhe muaji gusht i vitit 2022, i cili korrespondon me lejen vjetore.

44.20 Po ashtu, ai ka saktësuar se pas muajit gusht, në dy javët e para të muajit shtator, trajtohen materialet hetimore dhe kallëzuese të ardhura në prokurori gjatë muajit gusht, të cilat nuk janë trajtuar gjatë këtij muaji, që duhet të regjistrohen ose të vendoset mosfillimi i procedimit penal brenda afatit 15-ditor nga data e fillimit të punës pas pushimeve vjetore, e cila përkon me datën 5.9.2022.

Subjekti i ka trajtuar këto shkaqe si objektive, të pavarura prej tij, që kanë sjellë moskryerjen e veprimeve hetimore gjatë kësaj periudhe kohore për këtë çështje.

44.21 Subjekti ka konfirmuar se procedimi penal nr. *** i vitit 2021 nuk ka pasur të regjistruar emër si person që i atribuohet vepra penale apo person nën hetim dhe për këtë procedim penal nuk ka pasur afate hetimi në bazë të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë kuptim, është shprehur ai, nuk është cenuar asnjë afat hetimi apo afat paraburgimi në procesin penal.

44.22 Subjekti ka renditur veprimet e kryera pas muajit nëntor 2022 e në vijim, si dhe ka shpjeguar se janë pritur një sërë përgjigjesh nga institucionet me të cilat ishte mbajtur korrespondencë në dobi të hetimit. Subjekti, për të mbështetur shpjegimet e tij, ka depozituar disa dokumente¹⁰⁵.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

44.23 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, dokumentacionit të depozituar, në raport edhe me legjislacionin e zbatueshëm, çmon se argumentet e prezantuara nga subjekti, të faktuara gjithashtu edhe me aktet përkatëse, konsiderohen proporcionalisht provuese në këtë çështje, sikurse u provua edhe fakti i kryerjes së veprimeve hetimore prej muajit nëntor e deri në përfundimin e hetimeve të kësaj çështjeje.

45. Gjetje të tjera sipas të dhënave të aksesuara në media¹⁰⁶

45.1 Nga aksesi në median e shkruar është vërejtur se në një rast bëhet fjalë për një operacion policor në vitin 2013, i cili u njoftua me bujë në lidhje me disa arrestime në Universitetin e Elbasanit. Sipas shkrimit thuhet se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar si masë të sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore” për kancelarin e universitetit dhe kreun e drejtorisë ekonomike, ndërsa gjykata vendosi t’i lërë të lirë. Për dy zyrtarë të tjerë subjekti i rivlerësimit kërkoji masë të sigurimit personal, pezullimin nga detyra deri në përfundimin e hetimeve dhe jo arrestim. Me kërkesat e prokurorit dhe vendimin e gjykatës operacioni i bujshëm policor u shfry për punë ditësh.

¹⁰⁵ Vendim për zëvendësimin e prokurorit, datë 9.6.2022; procesverbal datë 16.11.2022 i këqyrjes së CD-ve, dorëzuar nga shtetasi A.E; shkrësë nr. *** prot./***, datë 22.11.2022, drejtuar drejtorisë së shëndetit publik G; shkrësë nr. *** prot./***, datë 22.11.2022, drejtuar qendrës shëndetësore “E.B” G; shkrësë nr. *** prot., datë 24.11.2022, e Qendrës Shëndetësore G; shkrësë nr. *** prot./*** datë 22.11.2022, drejtuar njësisë vendore të kujdesit shëndetësor, sektori i shëndetit mendor, G; shkrësë nr. *** prot., datë 25.11.2022, e njësisë vendore të kujdesit shëndetësor G, shkrësë nr. *** prot./***, datë 24.11.2022, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; shkrësë nr. *** prot., datë 2.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi C.Z, datë 30.11.2022; procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi M.Z, datë 1.12.2022; procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi R.M, datë 7.12.2022; procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Q.Z, datë 7.12.2022; procesverbal datë 30.12.2022 për këqyrjen e fashikullit dhe marrjen me fotokopje të akteve të vendimit të pushimit, datë 27.6.2013, nga procedimi penal nr. *** i vitit 2013; procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasja N.C, datë 17.1.2023; urdhër paraqitjeje, datë 22.11.2022, për shtetasin A.XH; procesverbal këqyrjeje i sistemit TIMS për shtetasin A.XH, datë 26.1.2023.

¹⁰⁶ https://www.***

45.1.i Komisioni administroi dokumentacionin¹⁰⁷ e fashikullit, që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2013, në ngarkim të shtetasve E.H dhe F.Q, akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Nga aktet rezultoi se:

45.1.ii Në datën 25.11.2013 është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasve E.H dhe F.Q për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”.

45.1.iii Shkurtimisht, në datën 25.11.2013, inspektorët e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, në bashkëpunim me specialistët e sektorit të kimit ekonomik dhe financiar të DPQ Elbasan, kanë ushtruar kontroll në objektin bar-kafe të shtetas L.XH, objekt i marrë me qira në ambientet e brendshme të universitetit “A.XH” Elbasan. Nga kontrolli është konstatuar se shtetasja L. XH nuk ishte e regjistruar për ushtrimin e aktivitetit në QKR; nuk lëshonte kuponë tatimorë për shërbimin në bar-kafe; punëtori që kryente shërbimin nuk ishte i siguruar. Ndodhur para kësaj shtate, inspektorët kanë kërkuar kontratën e qirasë, në të cilën kanë vënë re se ajo është lidhur në datën 7.1.2013 midis universitetit “A.XH”, përfaqësuar nga rektori L.V dhe shtetas L.XH, për marrjen me qira të një objekti funksional me sip. 65 m² dhe 50 m² truall. Nga inspektimi në vend objektit, sipërfaqja e përdorur për aktivitetin bar-kafe ishte rreth 163 m² më e madhe se sipërfaqja e deklaruar. Për verifikimin e rregullsisë së kontratës është marrë një kopje e saj nga shtetasi F.Q, me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike të universitetit. Kontrata ishte e pafirmosur nga qiramarrësi. I pyetur rreth këtij fakti, F. Q ka deklaruar se përgjegjës për ndryshimet në lokal është shtetasi E.H, me detyrë kancelar i universitetit. Është pyetur rektori i universitetit, z. L.V dhe ka deklaruar se përgjegjës për zbatimin e kontratës janë drejtori ekonomik, drejtori juridik dhe kancelari i universitetit. I pyetur, kancelari i universitetit E. H ka pranuar se për kontratën është përgjegjës vetë ai, drejtori ekonomik dhe drejtori juridik, ndërsa rektori i universitetit firmos kontratat e bëra nga ata. Në datën 25.11.2013, policia gjyqësore ka kryer arrestimin e shtetasit E.H dhe F.Q. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/subjekti për shtetasin E.H ka kërkuar në gjykatë me shkresën nr. *** prot., datë 27.11.2013, që të vlerësohet i ligjshëm arrestimi në flagrancë, të caktohet masa e sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore” dhe të caktohet masa e sigurimit ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a një shërbimi publik”, konkretisht i detyrës së tij si kancelar pranë universitetit “A.XH” Elbasan.

45.1.iv Këtë kërkesë të tij subjekti e ka mbështetur në faktin se shtetasi E. H, në cilësinë e kancelarit të universitetit, ka bërë një kontratë me shtetasen L. XH për dhënien me qira të ambienteve të universitetit për ushtrimin e aktivitetit bar-kafe. Gjatë hetimit u vu re se në kontratë sipërfaqja e dhënë me qira është shënuar më e vogël se ajo në përdorim dhe se shtetasja L. XH, përfituese nga kjo marrëveshje, është vjehrra e tij.

45.1.v Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka vlerësuar materialin hetimor paraprak të depozituar nga prokuroria dhe arsyeton se në rastin konkret nuk ka fakt penal që të përbëjë veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248¹⁰⁸ i Kodit Penal. Gjykata arsyeton se nga Prokuroria/subjekti në faktin e parashtruar si fakt penal mungojnë elementet që përbëjnë dëmtime të pronës publike nga persona që ushtrojnë funksione publike, dyshohet se kontrata është e parregullt, por nuk përcaktohen faktet ligjore të parregullsisë, dyshimet për ndryshim midis sipërfaqes së shënuar në kontratë dhe sipërfaqes që përdoret aktualisht, cilësohet procedurë e parregullt në bërjen e kontratës, por nuk përcaktohet se cila

¹⁰⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁸ Neni 248 i Kodit Penal: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyshje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

procedurë duhej të ndiqej. Bazuar në mungesën e faktit penal, gjykata në bazë të nenit 228/1¹⁰⁹ të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin nr. ***, datë 27.11.2013, ka vendosur “Vleftësim të paligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit E.H; Rrëzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore” dhe “Pezullimi për ushtrim të një detyre a funksioni publik”; Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim E.H”.

45.1.vi Vendimi nr. ***, datë 27.11.2013, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 23.12.2013, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

45.1.vii Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/subjekti për shtetasin F.Q, me detyrë drejtor ekonomik pranë universitetit “A.XH”, Elbasan, ka kërkuar në gjykatë me shkresën nr. *** prot., datë 27.11.2013, që të vlerësohet i ligjshëm arrestimi në flagrancë, të caktohet masa e sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”.

45.1.viii Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka vlerësuar materialin hetimor paraprak të kryer nga prokuroria dhe arsyeton se në rastin konkret nuk ka fakt penal që të përbëjë veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Nga Prokuroria/subjekti në faktin e parashtruar si fakt penal mungojnë elementet që përbëjnë dëmtime të pronës publike nga persona që ushtrojnë funksione publike, dyshohet se kontrata është e parregullt, por F.Q nuk është hartues i saj, cilësohet procedurë e parregullt në bërjen e kontratës, por nuk përcaktohet se cila procedurë duhej të ndiqej; F.Q nuk ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin për të përfituar nga zbatimi i kësaj kontrate. Bazuar në mungesën e faktit penal, gjykata, në bazë të nenit 228/1¹¹⁰ të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin nr. ***, datë 27.11.2013, ka vendosur “Vleftësim të paligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit F.Q; Rrëzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore” dhe urdhërimin e lirimit të menjëhershëm të personit nën hetim, F.Q”.

45.1.ix Vendimi nr. ***, datë 28.11.2013, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 23.12.2013, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

45.1.x Pas verifikimit të dokumentacionit të administruar, Komisioni nuk konstatoi shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe, për pasojë, as ndonjë problematikë që mund të ndikojë në vlerësimin e tij profesional.

45.2 Në shkrimin e raportuar thuhet se në vendimin prej 53 fletësh jepet një tablo e qartë e përpjekjeve të sekserëve dhe oficerëve të policisë për lirimin e një kamioni tip “Mitsubishi”, i cili ishte ngarkuar me dru, por ishte kapur nga policia e Gramshit. Sipas shkrimit, i hetuari Ç.T, oficer i policisë gjyqësore, i ngarkuar për hetimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit Z.T (pronari i kamionit), flet me prokurorin e çështjes/subjektin e rivlerësimit, ku, pasi e informon lidhur me veprimet hetimore të kryera prej tij, e pyet lidhur me makinën dhe nëse ajo është për t’u kthyer apo jo. Subjekti i kërkon që të mos merret me çështjen e makinës, për sa kohë nuk ka urdhër nga ai për ta kthyer.

¹⁰⁹ Neni 228/1 i Kodit të Procedurës Penale: “1. Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal, në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”.

¹¹⁰ Neni 228/1 i Kodit të Procedurës Penale: “Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal, në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”.

45.2.i Komisioni¹¹¹ kërkoi kopje të fashikullit penal për këtë çështje pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

45.2.ii Prokuroria, me shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2023, njoftoi se çështja është në proces hetimi.

45.3 Për sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nuk ka kompetencë për të trajtuar këtë çështje, për sa kohë ajo rezulton të jetë në proces hetimi.

46. Për sa u arsyetua më sipër, Komisioni, pas analizimit të denoncimeve, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se në tërësi ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit. Mangësia e konstatuar në çështjen e bërë prezent nga denoncuesit A.E, pasqyruar në rubrikën e trajtimit të denoncimeve të depozituara në Komision, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk është e mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij.

47. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë”.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

a) Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c) Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

¹¹¹ Me kërkesën nr. ***, datë 4.8.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arbër Berexha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.1.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka